



Historia

Dalipi me 2 gra, 25 fëmijë, e 100 nipër e stërnipër

► Faqe 8-9



Kriteret e BE

Romët i kërkojnë Bashës mbajtjen e premtimeve

► Faqe 7



Publicistikë

Zbulohen dy shkrime të panjohura të Fishtës

► Faqe 18-19

[SHQIPTARJA.com]

LEKË 30 SHQIPTARJA.com + Suplementi THASH&THEM

VITI III - NR. 206 E shtunë, 31-08-2013



KABINETI I RI

Ankth te disa nga kryetarët, mund të mbesin “pa gjë” në qeveri

PS, FRIKA E ALEATEVE TE GJITHE NE PRITJE TE TELEFONATES SE RAMES

Ngjela, Koçi, Muslia: Po presim. Koordinatori Ndoji: Jemi brenda limiteve. Nuk ka kërkesa të egzagjeruara drejt kryeministrit të zgjedhur... Javës tjetër pritet relatiimi për pretendimet ► Faqe 3

KABINETI I RI

► Faqe 2



Presidenca: Nuk ka vonesa, në 12 shtator dekretohet

Kushtetuta i lejon kreut të shtetit të mendohet 7 ditë për ministrant

NË IKJE

► Faqe 12

Olldashi sulmon ekspertët e Ramës

“Rreth influence, shfaqen herë si konkurrentë, herë si fitues”

SUPLEMENETI “THASH&THEM”

THASH&THEM
Klajda GJOSHA

KLAJDA GJOSHA

MARTOHET BEQARJA E QEVERISË RAMA

Ja detajet e ceremonisë me 350 të ftuar. Ministrija: Dua të ruaj intimitetin

► Faqe 13-17

Editorial



NGA ANILA BASHA

Grabitja e vonuar

Sali Berishës do t'ikëtëshkuar në mend që të kryejë të fundit grabitje të një prone, në qendër të Tiranës, objekt shtetëror por trull me pronësi private, siç raportohet më së fundi nga pronarët që kanë ardhur enkas nga SHBA, të alarmuar... ► vijon në faqen 21

Koment



NGA ILIR METAJ

Shshshshttt... Flet Fullani!

Dje, para se të rikonfirmohet nga kryeministri Berisha, Guvernatori i Bankes së Shqipërisë, Fullani: “Krizë ndërkombëtare nuk e preku Shqipërinë. Ekonomia jonë është solide!”

Sot, para se të rikonfirmohet nga Kryeministri Rama, Guvernatori... ► vijon në faqen 21

NERANXI

... gjithmonë një hap përpara...

Ushqime aziatike dhe meksikane

Adresa: Autostrada Tiranë - Durrës, km 7, Yrsheli Tiranë; Tel: 042 406 500; 042 406 501; Fax: 042 406 502; e-mail: neranxi@neranxi.com; www.neranxi.com

ANALIZA

► Faqe 20



NUKE NDIHMOM DOT, ATË QË NUK DO

NGA MIRELA SULA

IDAJET BEQIRI

► Faqe 10

SHQIPERIA DHE KOSOVA NE OKB PER KUFIJTE





KQZ miraton kamerat regjistruese në zgjedhjet e pjesësmë

Zgjedhjet e pjesësmë që do të mbahen në komunën Rrethinë dhe Dardhas janë në përgatitjet e fundit. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e djeshme shqyrtoi dhe miratoi me 4 vota pro projektvendimin "Për përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve për shfaqjen e fletëve të votimit në vendet e numërimit të votave për zgjedhjet e

pjesësmë për kryetar komune të datës 1 Shtator 2013". KQZ vendosi përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve, për shfaqjen e fletëve të votimit, në vendin e numërimit të votave për zgjedhjet e pjesësmë të datës 1 shtator. Ky proces është përdorur edhe në zgjedhjet pararendëse dhe tashmë KQZ disponon pajisjet kryesore të nevojshme për realizimin e tij. Ndërkohë në

mbledhjen e dy ditëve më parë KQZ ngriti shqetësimin për neglizhencën e partive politike për të paraqitur anëtarët për qendrat e votimit dhe grupet e numërimit, duke vënë në rrezik procesin. Hysen Osmanaj, apeloj partitë politike të zbatojnë kodin zgjedhor ose në të kundërt do të përballen me penalitete. Nëse pritet që qytetarët e këtyre dy komunave të zgjedhin kryetarin e tyre.

Procedurat ligjore që do çojnë në krijimin e kabinetit të ri qeveritar

Qeveria "Rama", gati brenda 12 shtatorit

Dekretet pritet të miratohen brenda 1 dite nga Nishani

LAJMI

Brenda 3 ditëve nga seanca e parë plenare që do të mbahet në 9 shtator, pritet që të fillojë punë dhe qeveria e re, e cila do të udhëhiqet nga kryeministri Rama së bashku me 19 ministrat e deklaruar nga ai.

TIRANE

ARTEMISA HOXHA

Qeveria e re "Rama" pritet që të nisë punë sa më shpejt të jetë e mundur, kjo pas përfundimit të procedurave ligjore në Parlament si dhe dekretimit të kabinetit të ri qeveritar nga presidenti, Bujar Nishani. Burime nga Presidencia, kanë bërë të ditur për A1 Report se presidenti Nishani do të dekretojë pa asnjë vonesë kabinetin e ri që në momentin që në tryezën e tij do të jenë emrat e ministrave të rinj që do të drejtojnë 19 dikasteret, të cilët do të mund të fillojnë punën brenda datës 12 shtator. Duke iu referuar nenit 98 të Kushtetutës, Presidenti do të emërojë ministrat me propozim të Kryeministrit, brenda 7 ditëve. Ndërkohë që burime cituan për A1 Report se një procedurë do të bëhet në një kohë të shkurtër, brenda 1 dite. Më pas dekretet do të kalojnë për shqyrtim në Kuvend, ku brenda 10 ditëve ata duhet të votohen nga Parlamenti. "Ministri emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës, me propozim të Kryeministrit, brenda 7 ditëve. Dekreti shqyrtohet brenda 10 ditëve nga Kuvendi", thuhet në Kushtetutë. Pas votimit dhe para fillimit të detyrës, Kryeministri, zëvendëskryeministri dhe ministrat betohen para Presidentit të Republikës. Por para se të shkohet te firmosja e dekreteve nga kreu i shtetit, më parë duhet

PYETJE PERGJIGJE

■ Sa do të zgjasë procedura e zgjedhjes së qeverisë së re?

Kushtetuta ka përcaktuar se brenda 10 ditëve që nga seanca e parë duhet që të zgjidhet qeveria e re, e cila nis që me procedurat e zgjedhjes në Parlament që në seancën e parë plenare e deri te betimi para Presidentit.

■ Kur votohet programi qeverisës?

Brenda 10 ditëve që nga zgjedhja e kryeministrit, në Kuvend do të hidhet për votim edhe programi qeveritar, i cili përmban strategjinë e ministrave për drejtimin e digastereve të caktuara.

■ A ka ndryshime në organizimin e qeverisë së re?

Po, kryeministri i ardhshëm Edi Rama para pak ditësh ka shpalosur dhe organizimin e qeverisë të ndara në ministri. Do të ketë katër ministri më shumë se qeveria e vjetër, nga të cilat 3 prej 19 ministrave do të jenë pa portofol. Në këtë qeveri janë zgjedhur dhe ministrat, të cilët janë nga dy partitë e mëdha të koalicionit të majtë, PS dhe LSI. Risi në këtë qeveri është dhe përfshirja e më shumë grave ministrave, ndryshe nga qeveria e vjetër që kishte vetëm një ministere femër.

të kalojnë disa hapa ligjorë që kanë lidhje me organin ligjvënës. Kështu, në seancën e parë të Kuvendit, të cilën presidenti Nishani e ka thirrur më 9 shtator, pritet të bëjmë betimin 140 anëtarët e rinj, deputetë të dalë nga vota e



Afati

Brenda 10 ditëve miratohet dhe programi politik i qeverisë



Ilir Beqja

shqiptarëve 3 muaj më parë. Në po të njëjtën seancë, do të zgjidhet kryetari i ri i Kuvendit, i cili sipas marrëveshjes PS – LSI do të propozohet të jetë, Ilir Meta. Kandidati për Kryetar të Kuvendit propozohet nga të paktën 15 deputetë. Ai zgjidhet pa debat dhe me votim të fshehtë, me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Pas

kësaj, propozohet nga grupi parlamentar më i madh emri i kryeministrit, i cili votohet dhe më pas i propozon presidenti Nishani propozimin për emërimin e qeverisë së re. Këtë dekret presidenti Nishani, sipas burimeve të A1Report, do ta firmosë brenda 24 orëve, duke siguruar njëherësh edhe vullnetin e bashkëpunimit me qeverinë e majtë, gjithashtu duke mos u bërë pengesë për fillimin e

me përbërjen e tij", thuhet në Kushtetutën e Shqipërisë. Ndërkohë që për programin e 300 ditëve të parë të qeverisë së re, partitë kanë mandatuar dy nga deputetët që do të jenë dhe ministra të qeverisë. Ilir Beqja i ngarkuar nga Partia Socialiste si dhe Edmond Haxhinasto i ngarkuar nga LSI janë dhe dy bashkëhartuesit e programit politik, i cili më parë i është vënë në dieni edhe ambasadorëve të vendeve europiane në vendin tonë.

menjëherësh të punës. Kësaj, sipas burimeve zyrtare, pas firmës së presidentit Nishani, më 12 shtator ministrat e PS e LSI do të ulen në zyrat e tyre për të marrë në duar drejtimin e vendit për 4 vitet e ardhshme. Referuar nenit 106 të Kushtetutës, Kryeministri dhe ministrat janë të detyruar të qëndrojnë në detyrë deri në formimin e Këshillit të Ministrave pasardhës.

AFATET

Ministri emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës, me propozim të Kryeministrit, brenda 7 ditëve. Dekreti shqyrtohet brenda 10 ditëve nga Kuvendi

NË FOTO: Rama gjatë takimit takimit me ministrat në Vlorë



Qeveria

Mëhilli: Largohem kur të iki dhe Berisha

Zëdhënësja e qeverisë, Erla Mëhilli ka përgjeshtruar lajmin e dorëheqjes së saj, duke theksuar se do të japë dorëheqjen ditën që Berisha do të dorëzojë postin e Kryeministrit. "Nuk e dija që paskam dhënë dorëheqjen. Nëse disa i kanë ngatërruar fotot që postova dje, po ju them se janë foto të vjetra të bëra gjatë këtyre viteve punë. Nuk kam dhënë asnjë dorëheqje. Unë largohem ditën që do të largohet Kryeministri", shprehet Mëhilli. Ndërkohë që Berisha mësohet se u ka kërkuar bashkëpunëtorëve të tij politikë që të japin dorëheqjen nga pozicionet që mbajnë.



Marrëveshja e PS me aleatët, ja çfarë përfitojnë

Kreu i PS Edi Rama ka nënshkruar marrëveshje parazgjedhore me aleatët. "...3.3 Pas fitores në zgjedhjet e 23 qershorit 2013, është e gatshme për të bashkëqeverisur me çdo forcë politike që përfaqëson një numër votash si shprehje të vullnetit të popullit, në nivel qarku nga 500 deri 1000 vota, dhe në nivel kombëtar 5000 deri 10.000 vota, pa cenuar statusin

e nëpunësit civil në respekt të çdo ligji që rregullon marrëdhëniet e administratës publike; 3.4 Për subjektet politike që do të arrijnë të marrin mbi 10.000 vota, do të ketë një bashkëqeverisje të shtrirë në nivel lokal dhe qendror; 3.5 Kur një parti politike e koalicionit, drejtpërsëdrejti, ka fituar një mandat në zgjedhjet e 23 qershorit, atëherë ajo ka të drejtë që të kërkojë një vend në

qeverinë e koalicionit pas zgjedhjeve; 3.6 Partia që ka fituar një mandat me anë të zbatimit të formulës së shpërndarjes së mandateve, përfitimim e saj në lidhje me qeverisjen sipas pikës 3.5 duhet ta diskutojë edhe me partitë e tjera, që kanë plotësuar numrin që u është dashur për të fituar një mandat;....!", thuhet në pjesën konkrete të marrëveshjes.



NË FOTO:
Edi Rama
me aleatët

Vonesat

Aleatët e tjerë, frikë nga mbetja pa asnjë post

Një pjesë e krerëve të partive aleate të socialisteve tek sa nuk kanë preferuar të prononcohen për gazetën, janë shprehur jo me zë për gazetën se po u sositë durimi në lidhje me arrijtjen e fiksimit të posteve në bashkëqeverisje sipas marrëveshjes me Ramën. Madje ata kanë shprehur frikë se mund të mbeten pa poste. Sipas tyre, kryeministri i zgjedhur ka mbetur jashtë vendit në vizita dhe takime, duke e neglizhuar takimin me krerët aleatë në mënyrë që të arrihet zbatimi i marrëveshjes parazgjedhore, bazuar në kontributin e rezultatin e secilës parti në zgjedhjet e 23 qershorit. Duke thënë se koha po ecën me shpejtësi, ata nuk ngurojnë të shprehen se socialistët dhe kryeministri i zgjedhur Edi Rama i kanë kushtuar rëndësi vetëm



Kryeministria

zbatimit të marrëveshjes qeverisëse me LSI dhe kreun e saj Ilir Meta, ndërkaq ende nuk po merr në konsideratë partitë e tjera aleate, që sëbashku i kanë dhënë koalicionit mbi 100 mijë vota. Pavarësisht se nuk e kanë humbur shpresën, durimi brenda partive aleate të Ramës me sa duket po sosit, dhe janë në pritje të javës së ardhshme për të takuar kryeministrin e zgjedhur.

Zbatimi i paktit me PS, Avokati: S'jam i shqetësuar

Ngjela: Jemi shoqëri që s'njeh marrëveshje

Aleatët: Ne, në pritje të takimit me Ramën

■ ■ ■ TIRANE

JAKIN MARENA

Aleatët e PS janë në pritje të takimit me kreun e zgjedhur të qeverisë Edi Rama për të vendosur piketat e marrjes së përgjegjësisë në bashkëqeverisjen e vendit. Përpos LSI e cila ka marrë pesë poste ministore dhe kreun e Kuvendit për kryetarin Ilir Meta, partitë e tjera ende nuk kanë arritur të fiksojnë postet që do drejtojnë sipas kontributeve për rezultatin e zgjedhjeve të 23 qershorit. Më konkret ka qënë kreu i PLD Spartak Ngjela, i cili ndonëse nuk ka shfaqur shqetësim në lidhje me zbatimin e marrëveshjes, është shprehur me tonë të hidhura në lidhje me respektin që ka shoqëria shqiptare ndaj marrëveshjeve. "Kjo është një shoqëri që nuk e njeh marrëveshjen që bëhet. Kjo është një shoqëri primitive që nuk e njeh zbatimin e termit 'marrëveshje'. Unë nuk jam i shqetësuar nga vonesa për takimin", ka qënë deklarata e Ngjelës për gazetën "Shqiptarja.com" në lidhje me interesimin tonë për kalimin çdo ditë e më shumë të kohës në funksion të implementimit të marrëveshjes parazgjedhore. Ngjela thotë se ai i ka dhënë pretendimet e tij e s'ka asnjë problem, vetëm pret që marrëveshja të zbatohet. Por Ngjela dhe para se të formatohej kabineti qeveritar nga Rama kishte deklaruar se kishte marrëveshje për një post ministri me kreun e PS, marrëveshje që nuk u zbatua dhe për të cilën kishte interpretime të ndryshme. Nëse Ngjela kishte kërkuar postin e ministrit të Drejtësisë, për të mbajtur përgjegjësi siç tha ai, Rama nënvizoi para mediave se Avokati e kishte refuzuar postin e ofruar. Bëhej fjalë për ministrin e Shtetit për marrëdhëniet me Parlamentin, post që aktualisht e mban Ilirian Celibashi. Nga ana tjetër Gjet Ndoj, kreu i AAK, njëherësh dhe koordinator mes aleatëve

Krerët aleatë, çfarë thanë

■ Spartak Ngjela-PLD:

Kjo është një shoqëri që nuk e njeh marrëveshjen që bëhet. Kjo është një shoqëri primitive që nuk e njeh zbatimin e termit 'marrëveshje'. Unë nuk jam i shqetësuar nga vonesa për takimin. Nuk di gjë se kur do bëhet takimi. Nuk na kanë thënë. Unë nga ana ime i kam dhënë pretendimet e mia dhe nuk kam asnjë problem. Pres që ato të zbatohen.



■ Petro Koçi-PSV 91:

Besoj se pjesëmarrja e aleatëve në bashkëqeverisje do zgjidhet në mënyrë parimore dhe përpjestuese, në raport me kontributet, vlerat dhe rezultatin elektoral të zgjedhjeve të 23 qershorit. Ne jemi në pritje të takimit.



■ Gjet Ndoj-AAK:

Ajo që unë do të them se jemi brenda limiteve kohore dhe padurimi nuk ka vend. Jemi brenda limiteve kohore për sa na përket ne si AAK. Për sa i përket punës si koordinator, vazhdoj konsultimet me aleatët për të parë se deri ku janë pretendimet, ku natyrisht është marrëveshja orientimi kryesor. Përgjithësisht ka dhe një mirëkuptim nga kryetarët e partive për të qënë brenda marrëveshjes, nuk ka pretendime të ekzagjeruara në adresë të kryeministrit të zgjedhur. Presim nga momenti në moment, ndoshta në javën e ardhshme që gjithë problematika të raportohet me kryeministrin e zgjedhur, në funksion të arrijtjes së akordit nga ana ime, ndoshta dhe nga krerët e partive aleate, për të definuar për secilin prej tyre marrëveshjen dhe implementuar atë në qeverisjen e pas pak ditëve.



■ Dhimitër Muslija-PKDSH:

Jemi në pritje të takimit, por ajo që mund të them është se ne jemi brenda afateve dhe limiteve kohore. Pasi marrëveshja zbatohet dhe kur të fillojë punë qeveria. Prandaj nuk ka asnjë vend për ngutje. Do presim që të zbatohet marrëveshja.



dhe kryeministrin të zgjedhur Rama, ka nënvizuar faktin se padurimi nuk ka vend, pasi gjithçka është breda afateve dhe limiteve kohore. Ai tha se

"aleatët nuk kanë pretendime të ekzagjeruara në adresë të Ramës" dhe se "presim nga momenti në moment, ndoshta javën e ardhshme që gjithë



Edi Rama

AVOKATI

Ngjela dhe para se të formatohej kabineti qeveritar nga Rama kishte deklaruar se kishte marrëveshje për një post ministri me kreun e PS, marrëveshje që nuk u zbatua dhe për të cilën kishte interpretime të ndryshme.

problematika të raportohet me kryeministrin e zgjedhur". Në të njëjtën linjë ka qënë dhe kreu i PSV '91 Petro Koçi, që ndonëse është në pritje të takimit me kryeministrin, tha se beson se pjesëmarrja e aleatëve në bashkëqeverisje do zgjidhet në mënyrë parimore në përputhje me vlerat dhe kontributin në zgjedhje. Dhe sekretari i përgjithshëm i Partisë Kristian Demokratë, Dhimitër Muslija është shprehur se nuk ka asnjë ngutje për takimin me Ramën dhe përcaktimin e përgjegjësisë në bashkëqeverisje, pasi "gjithçka është brenda afateve dhe limiteve kohore". Marrëveshja përcakton dhe numrin e votave që duhet të marrë çdo parti për të përcaktuar nivelin e përfaqësimit në qeverisje. Nëse merr një deputet në mënyrë të drejtëpërdrejtë, pavarësisht se nuk merr numër të madh votash, atëherë partia ka të drejtë të kërkojë post ministri përcaktuar marrëveshja e arritur me Ramën.

Stërvitja me trupat britanike, Berisha me Gjeneral Major Davis

Kryeministri Berisha priti kreun e Marinës britanike, Gjeneral Major Ed Davis. Dje, ndërsa Gjeneralmajor Xhemal Gjunkshi dhe ambasadori britanik Nicholas Cannon inspektuan stërvitjen "Albanian Lion-13" në Sazan, kreun në ikje i qeverisë ka vlerësuar rolin e Britanisë në reformimin e FA. Kryeministri në ikje Berisha i shprehu Davis kënaqësinë për bashkëpunimin duke thënë

se "jemi në një moment të perfeksionimit të ushtrisë shqiptare si një forcë profesioniste dhe synojmë modernizimin e mëtejshëm të saj". Kurse Gjenerali Ed Davis, në takimin me kreun në ikje të qeverisë shqiptare shprehu vlerësimin më të lartë për partnerët shqiptarë. "Stërvitja që zhvilluam ishte plotësisht e suksesshme dhe ne jemi të gatshëm të ofrojmë ekspertizën dhe logjistikën

tonë edhe në të ardhmen", deklaroi ai. Ushtria shqiptare dhe ajo britanike që po zhvillojnë stërvitje të përbashkëta në ishullin e Sazanit, i kanë intensifikuar marrëdhëniet me tyre. Aty janë dislokuar rreth 400 trupat britanike dhe një kompani këmbësorie e batalionit të Këmbësorisë të Poshnjës, të cilët po punojnë së bashku me trupat britanike në stërvitjen e konceptuar për t'iu përgjigjur terrorizmit.

Kryetari demokrat pret në selinë e re ambasadorin amerikan

Basha takon Arvizu PD-ja e ka sulmuar

Ambasadori: "SHQUP", SHBA këshillon objektivitet

LAJMI

Ambasadori amerikan në Tiranë Alexandër Arvizu është takuar dje në selinë e re të PD me kryetarin e ri demokrat Lulzim Basha. Zhvillimet politike, polemikat që kanë lindur për shkakt të kalimit të SHQUP të PD dhe bashkëpunimi, objekti i bisedës.

TIRANE

JAKIN MARENA

Ambasadori amerikan Alexandër Arvizu është takuar dje me kreun e ri të PD, njëherësh kryetar i Bashkisë së Tiranës Lulzim Basha. Teksa takimi është zhvilluar në selinë e re të PD, pikërisht të ish-SHQUP që i kaloi me vendim qeverie e dekret presidencial, Arvizu nuk ka munguar të bëjë sqarimet në lidhje me këtë takim në selinë e re por dhe për problemet që kanë ish-pronarët shtetas amerikanë me qeverinë për këtë godinë. Ai ka nënvizuar faktin se ky ishte një takim i shtyrë, i planifikuar të selia e vjetër. "Folëm për një proces që është shumë i rëndësishëm për PD-në si opozitë dhe metaforikisht, "në krye të autobusit duhet të jenë të gjithë". Dua të vlerësoj gjithashtu vendndodhjen ku jemi takuar sot, selinë e PD. Çështja e kësaj prone ka qënë subjekt i polemikave të ndryshme, por SHBA nuk marrin anësi kundrejt saj, ne këshillojmë përmbajtje ndaj shtetit ligjor dhe objektivitet. Ky takim ishte parashikuar më herët, në selinë blu. Më pas, mësuam se PD ishte zhvendosur këtu dhe kjo shpjegon arsyen pse ndodhemi këtu", tha ambasadori Arvizu në deklaratën e përbashkët me Bashën. Ai ka garantuar se SHBA nuk merr anësi por kërkon trajtim ligjor e me objektivitet për rastin e godinës së SHQUP. Duke iu kthyer takimit me Bashën, Arvizu vlerëson bashkëpunimin me PD dhe uron rrugëtim të shpejtë të vendit drejt BE. "Pasi zoti Basha u zgjodh krye i ri i PD kam pasur mundësi të shkëmbej një informacion jo zyrtar duke e përgëzuar për detyrën. Tani pata rastin ta takoj. Dua ta falenderoj z. Basha për bashkëpunimin afatgjatë e dëshiroj që ai të vazhdojë dhe në të ardhmen. Folëm për qëllimin e përbashkët të gjithë shqiptarëve, pavarë-



Takimi i Lulzim Bashës me ambasadorin amerikan Aleksandër Arvizu

sisht bindjeve të tyre politike, që është shtegu European i Shqipërisë, shtegu euroatlantik, rruga drejt Brukselit", tha Arvizu. Ndërsa kreun i PD Basha në takim me ambasadorin e SHBA, Arvizu kishte në krahun e djathtë ish-kreun

e PD Eduard Selami të kthyer pas 15 vitesh nga SHBA, sekretarin aktual ndërkombëtar Gerti Bogdani dhe dy zëdhënës e PD. Në ndryshim nga lidhshipi aktual i PD që ka mbajtur qëndrim armiqësor ndaj ambasadorit Arvizu,

konkretisht Topalli, Pollo, Çollaku por dhe të tjerë, Basha me sa duket ka vendosur të jetë më luajal, teksa ka dalë në konferencë të përbashkët për mediat me ambasadorin në largim të SHBA. "Kam prituri në selinë e re të PD Amba-

sadorin e SHBA, Arvizu, Zv. Ambasadorin Jardine dhe dy bashkëpunorë të rinj që sapo kanë mbërritur në Tiranë. Është takimi im i parë me të në detyrën time si kryetar i PD e me këtë rast shkëmbyem pikëpamjet tona mbi një sërë çështjesh që nga procesi i 23 Qershorit, perspektiva e PD mbi të ardhmen e vendit dhe çështje të rëndësishme të integritimit European dhe bashkëpunimit Euro-Atlantik si dhe roli i PD si një opozitë e fortë balllore, krijuese e moderne në mbrojtje të interesit publik, në mbrojtje të interesit të qytetarëve Shqiptarë", tha Basha pas takimit.

Të zhdukurit e komunizmit

Ndregjoni: Nuk janë gjetur ende eshtrat e 4500 të pushkatuarve

TIRANE

Nuk ka qetësi për viktimat e komunizmit, të cilët për vite e vite me radhë u kanë gjetur të drejtën e tyre jo vetëm për dëmshpërblimin, por dhe për gjetjen e të zhdukurve gjatë këtij regjimi të egër që për 45 vite me radhë u sundua me dorë të hekurit nga Enver Hoxha. Kështu, familjarë të të vrarëve nga regjimi komunist kanë përkujtuar dje Ditën ndërkombëtare të të zhdukurve, mes të cilëve radhitën edhe të afërm të tyre. Ata fajësojnë politikën dhe qeveritë postkomuniste për harrësë dhe mungesë vëmendjeje për të gjetur të vrarët e diktaturës, në mënyrë që familjarët e tyre të kenë ku të vendosin një buqetë me lule. "U mbushën 23 vite që s'janë gjetur esh-



Të zhdukurit në kohën e komunizmit

trat e 4.500 të pushkatuarve pa gjyq nga diktatura dhe sot ata vijnë në të njëjtë harruar nga klasa politike. Këta njerëz sfiduan padrejtësinë e terrorit me kurajon e tyre, por kur mbushen 23 vjet nga

AMBASADORI

"Dua të vlerësoj vendndodhjen ku jemi takuar sot, selinë e PD. Çështja e kësaj prone ka qënë subjekt i polemikave të ndryshme, por SHBA nuk marrin anësi kundrejt saj, ne këshillojmë përmbajtje ndaj shtetit ligjor dhe objektivitet".

EKSPONENTE TE PD PER AMBASADORIN:

Topalli-Arvizu's:
Një njeri i vogël
dhe falsifikator

Kryetarja e Kuvendit në largim Jozefina Topalli ka sulmuar ashpër ditë më parë, me fjalë denigruese ambasadorin amerikan, Alexander Arvizu. Ajo e ka quajtur atë "njeri i vogël", "falsifikator të historisë", "i denjë për të punuar me Reis Malien". Edhe pse Topalli nuk i ka përmendur emrin, duke cituar dhe komentuar deklaratën e ambasadorit amerikan, e nënkupton se i adresohet atij. Ky reagim pas deklaratës së Arvizu në seminarin e të rinjve të LRI në Jalë se zgjedhjet e vitit 2013 ishin po aq të rëndësishme sa ato të vitit 1992.

Pollo: Arvizu të
mësojë çfarë është
totalitarizmi

Reagoi edhe ministri Genc Pollo në faqen e tij në Facebook mbi deklaratën e ambasadorit amerikan, Arvizu se "zgjedhjet e 2013-s kanë rëndësi si ato të 1992". Pa i përmendur asnjë çast emrin, por duke e etiketuar me përsëritje "personazhi", Pollo ka thënë se "personazhit dikush duhet t'i sqarojë se kalimi nga një regjim totalitar në një sistem demokratik nuk është i krahasueshëm me një ndryshim të pushtetit, që në demokraci ndodh përmes kutisë së votimit. Edhe për të mesuarit vlen shprehja "më mirë vonë se kurrë". Duke pilotuar në këtë mënyrë kuadrin e sulmeve ndaj ambasadorit në ikje të SHBA.

Çollaku: Arvizu
po krahason të
pakrahasueshmen

Pas deklaratës së Arvizu reagoi dhe zv.ministri i Jashtëm në largim Kreshnik Çollaku. Për të, "të krahasosh ngjarjet është naive e provokuese ndaj historisë së vendit. Asgjë e pazakontë s'ka ndodhur në 2013 përveç një proces normal alternativ politik. E pazakonta është se ambasadori me mandat të mbaruar Arvizu, duke u ngritur në rrezet e diellit të Jalës më Metën të cilin u murte dua aq shumë ta bllokonte pjesëmarrjen në qeverinë e shkruar e shokorin vendimet e gjykatave që e shpallnin të pafajshëm) krahason të pakrahasueshmet. Por siç i thonë këtu nga ne, me gushin ikën dhe vapa, e shokorin duket do ikë dhe historia mosrespektime të vërtetave historike dhe e ambasadorëve tifoze".



Balla: Dorëheqja e Sokol Ramadani, interesa me Berishën

Dorëheqja e kreut të Entit Rregullator të Energjisë, Sokol Ramadani, për t'u punësuar në një kompani private, përveçse është një shkelje e ligjit, është edhe një favorizim që u bëhen zyrtarëve të lartë, të cilët kanë favorizuar kompanitë private sa kohë kanë qenë në pushtet. Sipas deputetit socialist Taulant Balla, Ramadani është shok i ngushtë me Shkëlzenin, i cili ka

interesa në kompaninë "Energji Ashta". "Rasti i kryetarit të ERE-s Sokol Ramadani, i cili me votën e Parlamentit ishte zgjedhur në krye të Entit Rregullator të Energjisë, por që dha dorëheqjen për të kaluar menjëherë tek një kompani private që vepion në sektorin energjetik, është një rast tipik konflikti i interesit. Ligji përcakton qartë rastet e konfliktit të interesit për zyrtarët

shtetërorë dhe është pikërisht Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive që duhet t'i hetojë këto raste. Kryetarit të ERE nuk i lejohej të punësohet menjëherë në një kompani e cila zhvillon aktivitet në fushën e energjisë. ILDKP duhet të marrë në hetim edhe aktin e dorëheqjes. Por, ILDKP për rastin në fjalë as që nuk është kujtuar", thotë Balla.

"Të gjithë janë të lidhur me rreth influence"

Olldashi sulmon ekspertët e huaj

Ministri në ikje akuzon Edi Ramën

LAJMI

Pjesëmarrësit në konferencën e organizuar nga PS për urbanistikën janë vënë nën shënjestrën e ministrit të Punëve Publike në ikje, Sokol Olldashi. Sipas tij, ata janë klientë të vjetër të ish-kryebashkiakut Rama, ndërsa ky flet për ligje e rregulla që janë vendosur tashmë

TIRANE
GENC KONDI

Ministri i Transporteve, Sokol Olldashi, akuzoi të premtën Edi Ramën se në konferencën e organizuar në fillim të kësaj jave në Tiranë ishin të pranishëm ekspertë që përbënin rrethin e klientëve të tij. "Kemi të bëjmë me një rreth të mbyllur pseudoekspertesh, pasi më duhet të pranoj se midis tyre ka ekspertë vërtet të veçantë, por është rreth influence që shfaqen here si konkurent, herë si anëtar jurie e herë si fitues. Ky është rrethi i klientëve të zotit Rama, si kryetar Bashkie", deklaroi Olldashi gjatë një konference për shtyp në ministrinë e PPT.



Sokol Olldashi

Lidhur me propozimin për kthimin e vilës së Enverit në një vend ku mund të mbyllet filozofët, Olldashi thase i vetmi që mund të pranojë diçka të tillë është Koço Kokëdhima. "Propozohet që filozofët të hyjnë në dhomën e gjumit të Enver Hoxhës, të mendohen dhe të thonë si do jetë Shqipëria. Imagjironi Ramën që mbyllet 3 muaj në dhomën e Hoxhës, i

vetmi që do të pranonte është Koçoja, por edhe atë mbetet ta pyesim", tha Olldashi.

Sipas tij, për ndërtimet në bregdet ne jemi nën moratorium. Praktikisht edhe propozimi për një gjë të tillë është i paqëndrueshëm, tha ai, pa komentuar lidhur me dhjetëra ndërtime, që pasqyrohen edhe në faqen e internetit eëë.storrenime.com.

ARMO




Erjon Braçe: Ministri të përgjigjej për abuzimet

Në vend që të zbulojë "grupe armiqësore", ministri i qeverisë së mundur në zgjedhje duhet të japë llogari për dëmet që po i bëhen në fundmandati pronës së shtetit, ka deklaruar dje në FB deputeti socialist Erjon Braçe. Sipas tij, Olldashi si ministër ka se ç'ligori të japë për shpërbërjen e Portit të Durrësit, rritjen e tarifës së kolaudimit të makinave, ndërkohë që si deputet i Qarkut të Fierit duhet të thotë diçka lidhur me lejen e rishitjes së ARMO-s, pa marrë parasysh interesat e punonjësve, shpërbërjen e Albpetrolit apo shitjen brenda parkut kombëtar të Divjakës të objekteve turistike, pronë e bashkisë, në shkelje të ligjit dhe pa patur parasysh interesin publik. Sipas Braçes, Olldashi ka dalë para medias si komisar i diktaturës, ndërkohë që ka denigruar ekspertët e urbanistikës në konferencën e PS, që janë "thelbi i Evropës për art, kulturë e pasuri".

Ndërkombëtarët

Banka Botërore: Konferenca e PS, pikënisje pozitive

Nga ana e saj, drejtoresha e Bankës Botërore për Europën Juglindore, Ellen Goldstein, e ka konsideruar konferencën e organizuar nga Partia Socialiste, "Shqipëria e Gjeneratës tjetër", si një pikënisje të mirë për t'u përballur me sfidat e ekonomisë. Duke vlerësuar idetë e dala në konferencë, ajo deklaroi për median se ka dy sektorë, ku qeveria e re duhet të përqëndrohet për të mos lejuar që vendi të bjerë në krizë, i pari sektori i energjisë, i cili është në probleme të thella prej kohësh ngaqë nuk është menaxhuar siç duhet dhe sektori financiar. Ky është goditur tashmë nga një rritje shumë e shpejtë e kredive të këqija, të cilat janë



Ellen Goldstein

rritur nga 5 në 25 për qind. Zonja Goldstein mendon se përqendrimi i cilësive së kredive e kombinuar me sjelljen fiskale të qeverisë gjatë viteve të fundit mund të frenojnë rritjen ekonomike. Duhet që qeveria të paguajë detyrimet e prapambetura ndaj biznesit, shtoi ajo, për të ndihmuar ekonominë shqiptare të rritet më shpejt.

Bankat

Kredia shënon rënien më të lartë

Kredia e bankave të nivelit të dytë ka rënë në muajin korrik me ritmet më të larta historike

TIRANE

Viti 2013 rezultoi të jetë viti më i keq përsa i përkjet financimit të ekonomisë nga institucionet bankare në vend, që nga fillimi i viteve 2000, kur sistemi bankar filloi të zhvillohej vullshëm. Bankat janë përqendruar vetëm në kthimin e kredive dhe sidomos në rikuperimin e atyre me probleme, duke e ndërprerë tërësisht huadhënien për bizneset apo individët. Stoku i huasë për ekonominë ka shënuar rënien më të thellë mujore në korrik, që nga viti 2002 kur Banka e Shqipërisë raportoi të dhënat, bëhet e ditur nga statistikat e fundit të in-



stitucionit monetar qëndror. Kredia për ekonominë zbriti me 9,4 miliardë lekë, apo 1,7% në 547,8 miliardë lekë në korrik, në raport me qershorin e këtij viti. Një rënie në këto nivele nuk është konstatuar asnjëherë në dekadën e fundit. Tkurria më e thellë, sipas statistikave të Bankës së Shqipërisë, deri tani ishte konstatuar në qershor 2009, me rreth 5 miliardë lekë. Në raport me dhjetorin 2012, kredia për ekonominë është tkurur me 6,8 miliardë lekë, apo 1,2%. Një vit më parë ndryshimet përkatëse ishin plus 10,7 miliardë lekë dhe plus 2%.

Ndryshimi vjetor (korrik 2013/korrik 2012) është minus 4,7 mil-

iardë lekë, apo gati minus 1 për qind. Një vit më parë ndryshimet përkatëse ishin plus 36 miliardë lekë dhe plus 7%. Tkurria e kredisë për korporatat në valutë ishte arsyeja kryesore që ndikoi në këtë performancë kaq negative në korrik, duke shënuar një rënie me 8,6 miliardë lekë, në 243,2 miliardë lekë. Ndërkohë, huaja në lekë nuk shënoi rritje as për biznesin e as për individët. Bankat kanë cilësuar si shkaktar të ndërprerjes së kreditimit nivelin e lartë të huave me probleme, që po i afrohet 25 për qindëshit, më i larti në rajon. Në mungesë të kreditimit, ato po i investojnë fondet e lira në blerjen e letrave me vlerë të qeverisë.



Shkodër, policia djeg rreth 700 rrënjë kanabis në toka pa pronar

694 rrënjë kanabis sativa janë sekuestruar nga forcat e policisë së Shkodrës në të ashtuquajturat "toka pa zot". Pas informacioneve të marra në rrugë operative dhe monitorimeve të kryera nga ajri me helikopter, nga ana e shërbimeve të policisë të Komisarariatit të Policisë Shkodër, është ushtruar kontroll në vendin e quajtur "Çoka e Kirit", komuna Pult e Shkodrës. Atje u gjetën

3 parcele, në të cilat ishin mbjellë 215 rrënjë bimë narkotike Cannabis Sativa, të cilat pasi u shkëlën, u asgjësuan me anë të zjarrit. Ndërkohë, forcat e policisë kanë ushtruar kontroll edhe në vendin e quajtur sipër lagjes "Ndreaj", fshati Ndreaj, ku u gjetën 6 parcele, në të cilat ishin mbjellë 479 rrënjë bimë narkotik. Në të dyja rastet, lënda narkotike ka qënë e mbjellë në toka pa pronarë të ligjshëm, në sipërfaqe

që i përkasin pyjores dhe prangosja e poseduesve ka qënë e pamundur. Cannabis Sativa vazhdon të kultivohet ende në zona të ndryshme të Dukagjinit në toka pa pronar. Parcelat të cilat kultivohen në toka pa pronar hapen nga honorë e zonës, të cilët gjejnë edhe burimin e ujit për të vaditur këto bimë, ndërsa në momentin kur zbulohen nga forcat e policisë, parcelat braktisen nga mirëmbajtësit e tyre.

Policia: Debati për një borxh prej 300 mijë lekë

I plagosuri: Nuk i kam borxh askujt


Autori Simon Leka person me precedent penal

LAJMI

Pas ngjarjes e cila u shënua pasditen e së enjtes, ku u plagos me pistoletë 32-vjeçari Erion Çoba, ai tregon se nuk i ka borxh askujt dhe se kjo që ndodhi ishte diçka e momentit. Ndërsa burime nga policia bëjnë të ditur se shkak i kësaj plagosjeje janë bërë 300 mijë lekë që i lënduari i kishte borxh 35-vjeçarit Simon Leka.

■ ■ ■ TIRANE
JONIDA ALIU

"Ishte diçka e momentit. Nuk e prisja që të ndodhte kjo gjë. Nuk i kam borxh askujt. Autorin e njoh por nuk është se kam pasur ndonjë konflikt apo problem me të". Janë këto fjalët e 32-vjeçarit, Erion Çoba, i cili u qëllua me dy plumba pasditen e së enjtes, duke mbetur kështu i plagosur. Ngjarja ndodhi rreth orës 17:00 dt.29.08, në rrugën "Selaudin Zorba", zonën e Alliasit në kryeqytet, kur i riu po lëvizte me një motoçikletë. Çoba i cili ndodhet i shtruar në spitalin Ushtrarak të Tiranës rrëfen për "Shqiptarja.com" se kjo ngjarje nuk ka si shkak paratë dhe se ai nuk i ka borxh autorit. Ai thotë se çdo gjë ishte momentale dhe se autorin e njeh vetëm si fytyrë. "Të më falni por nuk mbaj mend gjë më tepër" përfundon 32-vjeçari. Por, ende mbeten enigmë rrethanat e ngjarjes dhe lidhja që Çoba ka pasur me 35-vjeçarin Simon Leka. Sipas burimeve të policisë shkak për këtë ngjarje është një borxh i pashlyer që 32-vjeçari Erion Çoba i ka mar-



I plagosuri Erion Çoba, (djathtas) Vendi ku ndodhi ngjarja

rë autorit që prej një viti që ka të bëjë me rreth 300 mijë lekë. Leka e ka telefonuar 32-vjeçarin dhe ata kanë lënë që të takohen. Por në momentin që 32-vjeçari ka shkuar në vendin e takimit ata kanë debatuar ashpër mes tyre pasi Çoba i ka thënë që do t'ia kthente një nga këto ditë paratë, por i dyshuari nuk është bindur, pasi kishte kohë që i kërkonte

paratë, i ka zënë pritë dhe e ka qëlluar dy herë me pistoletë. Më pas është larguar në drejtim të zonës së Babrussë. 32-vjeçari ka marrë një plumb në gjoks që i ka dëmtuar mëlcinë dhe një tjetër në kofshë. I riu është transportuar me urgjencë në Spitalin Ushtrarak, ndërsa policia ka shoqëruar dy dëshmitarë që ndodheshin pranë vendit të ngjarjes në momentin që

Erion Çoba është qëlluar me armë zjarri. Dëshmitarët kanë treguar vetëm momentin e krimit, ndërsa janë shprehur se nuk ishin në dijeni të konfliktit që mund të kenë pasur i dëmtuari dhe autori, pasi nuk i njihin asnjërin prej tyre, por i kanë dëgjuar duke debatuar në rrugë. Dje mjekët thanë se 35-vjeçari ndodhet jashtë rrezikut për jetën.

Ndërsa, policia është vënë në kërkim të autorit të ngjarjes Simon Leka. Leka është person me precedent penal, pasi në vitin 2010 ai është kapur në Lezhë me pistoletë pa leje. Kurse në vitin 2002, 35-vjeçari është arrestuar për vjedhje në Itali dhe në atë kohë, policia italiane ka deklaruar se Leka ishte i kërkuar në Shqipëri për vrasje.

Tiranë Florenc Hoxha përplasje me policinë për një ndërtesë



Florenc Hoxha

Ti polici dhe Inspektorati Ndërtimor Urbanistik i Tiranës, janë përplasur dje rreth mesditës, për një objekt pa leje pranë ish-kombinatit "Misto Mame" në Tiranë. Një godinë të cilës po i hidhej kati i dytë është kthyer në mollë shërri, duke përplasur edhe kolegët. Një polici private, si dhe efektivët e komisarariatit numër 6, nuk kanë lejuar të hyjnë brenda objektit,

inspektorët ndërtimor me krye Florenc Hoxhën, dhe policinë bashkiake të Tiranës, pasi sipas pretendimeve të tyre, për objektin në fjalë, ka një vendim gjykatë, i cili ndalon veprimet për bllokimin e punimeve. Madje, kanë qënë vetë përmbaruesit, të thirrur nga vetë pronari Besnik Canaj, ata që kishin kërkuar ndihmën e komisarariatit 6 dhe një policie private.

Fier Helmimi nga kuzhinieri i infektuar me salmonelë



Në prej dasmorëve të helmuar

Disa ditë pas helmimit masiv, Drejtoria Drejtoria e Higjienës dhe Shëndetit Publik në Fier, ka zbuluar shkaqet sëmundjes së rreth 150 dasmorëve, ngjarje e ndodhur në fshatin Gorishovë të Mallakastërës. Ka qënë vetë drejtori i zyrës së higjienës Laze Bregasi ai i cili ka deklaruar se pas analizave parapake të

kryera në laboratorët e këtij institucioni, u zbuluan ngarkesa mikrobiologjike kryesisht në gatimin e qofteve. Sipas tij, analizat paraprake të cojnë në përfundimin se, helmimi i dasmorëve ka ardhur si pasojë e virusit të salmonelës i mbartur nga kuzhinieri. Aktualisht është mbyllur lokali, si dhe është gjobitur kuzhinieri.

LAJME SHKURT

■ Vrasja për gërvishtjen e makinës, akuzat: Ishte nga pakujdesia

Prokuroria e Tiranës ka ngritur akuzën e "vrasjes nga pakujdesia", për Artenc Shehun, i akuzuar për vrasjen e Gëzim Karajit, 60 vjeç në vendin e njohur si "Fusha e Ali Demit". Dosja është çuar në Gjykatën e Tiranës, ndërkohë që pritet që ditën e nesërme (e shtunë) të jepet edhe masa e sigurisë ndaj Shehut. Më pas ka shkuar dhe Artenc Shehu, i cili ka qëlluar 60-vjeçarin Karaj, duke i shkakuar edhe vdekje. Sipas policisë viktimat është goditur me grusht.

■ Durrës, kapen 43 kg kanabis, në pranga 43-vjeçari

Në orët e para të mëngjesit të djeshëm, Policia e Durrësit ka vënë në pranga Prel Kolnikajn, 43 vjeç, banues në fshatin Kulnikaj, në Malësi të Madhe. Arrestimi i 43-vjeçarit është bërë pasi gjatë kontrollit të ushtruar në bagazhin e autoveturës Ford Focus me targa CG916RG, u gjejnë një çante me 68 pako me përmbajtje masë të thatë bimore që dyshohet të jetë narkotike e llojit kanabis sativa, që pas peshimit rezultoi në peshën 43.1 kilogramë. Automjeti në fjalë do të niset me tragjetin "Michela" për në Bari ku ishte edhe destinacioni i lëndës narkotike.

■ Tiranë, sherr dhe plagosje me thikë, në pranga i kërkuari

Policia e Tiranës ka vënë në pranga të dyshuarin e dytë, pasi akuzohet për një plagosje të ndodhur disa ditë më parë në kryeqytet. Burimet zyrtare thanë se, nga efektivët e seksionit të Kërkimit në afërsi të rrugës "Ali Demi", është bërë kapja e personit në kërkim Ermal Kreka, 26 vjeç, lindur Korçë dhe banues në Tiranë. Sipas policisë, 26-vjeçari ishte i shpallur në kërkim pasi në datën 21 gusht 2013, rreth orës 11:30, në Qendërën Spitalore "Nënë Tereza", ka shkuar i dëmtuar me thikë në pjesë të ndryshme të trupit Erton Gjona, i plagosur pas një konflikti për motive të dobëta nga Ermal Kreka dhe Elton Kreka (vëllezër të arrestuar). Por për shkak të plagëve të marra, Erton Gjona është dërguar në Spitalin Ushtrarak. Ndaj Ermal Krekës, është ngritur akuzat e "plagosjes së rëndë me dashje".



Protesta

“ROMËT protestë ndaj kryetarit të Bashkisë Lulzim Bashës. “Romët janë pjesë e shoqërisë shqiptare”, “Sa familje rome kanë marrë kredi shtesë?!” , “Ne ju shohim po ju na shihni?!”.

Shefja e postës



Lushnje, vodhi 8 mln pensionistëve, arrestohet

Shefja e zyrës postare e fshatit Këmishtaj është arrestuar pasi akuzohet se me anë të falsifikimit të dokumenteve ka vjedhur paratë e pensionistëve të këtij fshati. Bëhet fjalë për një shumë prej 8 milionë e 170 mijë lekëve të reja. Arrestimi i Hatixhe Dakës, 44-vjeçe, është bërë pas urdhër-arrestit të firmosur nga prokuroria. Daka akuzohet për shpërdorim detyre dhe falsifikim dokumentesh. Operacioni i arrestimit u kodua “Pensioni”. Policia vijon hetimet për zbulimin e personavë të tjetër të përfshirë në këtë vjedhje.

“Respekt siç thotë BE, mendoni për ne”

Familjet rome jetojnë në kushte të mjerueshme

LAJMI

Dhjetra të rinj të komunitit rom, dhe jo vetëm, protestuan dje paradite para Bashkisë së Tiranës. Prej 28 ditësh familjet rome jetojnë në kushte të mjerueshme në çadra të ngritura provizorisht në trotuar në rrugën e Kavajës, pasi u dëbuan nga kampi ku jetonin prej vitesh tek zona e Ish-Dekorit pranë Pallatit me Shigjeta.

■ ■ ■ TIRANE

SUELA GERA

Për gati një orë të rinj, dhe pjesëtarë të familjeve të dëbuara, protestuan me pankarta në duar, ku shkruhej: “Romët janë pjesë e shoqërisë shqiptare”, “Sa familje rome kanë marrë kredi shtesë?!”, apo “Ne ju shohim po ju na shihni?!”. Me megafonë protestuesit i kërkuan kryetarit të Bashkisë Lulzim Basha të reagojë duke i kujtuar se duhet të plotësojë një nga 12 kriteret e statusit të BE-së, që ka të bëjë me respektimin

e të drejtave të njeriut të këtij komunitet. Gjithashtu ata i kujtuan edhe fushatën e 2011 kur Basha kishte shkuar për të marrë votën me premtimin se do i përmirësonte jetesën e tyre. “Qyteti që premtuat se do ta kthenit në qytetin e qytetarëve, kërcënon cdo ditë familjet rome, të cilët ndryshe nga të tjerët nuk ndërtuan kështjella. Jeni në këtë zyrë për t’i dëgjuar dhe mbrojtur këto familje rome. Plotësoni një nga kushtet që ju ka vendosur BE. Mendoni për këta romë që po jetojnë në mjerim.” - ishin disa nga deklaratat e të rinjve të cilët i lexonin me megafon përpara bashkisë. Ata kanë kërkuar ndërhyrjen e



Protesta e romëve përpara bashkisë së Tiranës

PROTESTA

Gjithashtu ata i kujtuan edhe fushatën e 2011 kur Basha kishte shkuar për të marrë votën me premtimin se do i përmirësonte jetesën e tyre.

këtij institucioni për të dhënë një zgjidhje që të mos jenë viktima të këtij realiteti. Të rinjtë kanë kërkuar edhe shpjegime në lidhje me politikën e strehimit të Bashkisë së Tiranës, pasi banesat sociale nuk janë dhënë ende për shfrytëzim, fëmijët e komunitit rom të jenë të barabartë në shkollë, të jenë të barabartë në shërbimin shëndetësor. “Çfarë bëhet

me ne. Sa familje rome kanë përfitur nga bonusi i përfitimit, kredi apo banesa sociale që janë ngritur në Shkozë?” Gjithashtu protestuesit kanë bërë thirrje që kjo çështje të mos politizohet. Ata kanë kërkuar nga kryebashkiaku që të flasë me vepra në të mirë të këtyre banorëve romë, e “të mos flasë për prapaskena politike.”



QENDRA KOMBËTARE E
EDUKIMIT NË VAZHDIM



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Albania
Zyra e Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri

NJOFTIM MBI PROGRAMIN E RICERTIFIKIMIT TË PROFESIONISTËVE TË SHËNDETËSISË!

Ju rikujtojmë se detyrimi i mjekëve për vitin 2013 është 40 kredite; detyrimi i farmacistëve dhe dentistëve për vitin 2013 është 20 kredite.

Po kështu ju duhet të kontaktoni me QKEV-në për të mundësuar njohjen dhe regjistrimin e krediteve të edukimit në vazhdim nga aktivitetet e mëposhtme: leximi i literaturës shkencore (libra artikuj, etj), botimet shkencore, aktivitetet e të mësuarit në distancë, si dhe konferenca e trajnime të akredituara jashtë vendit.

Për informacion më të detajuar, vizitoni faqen e Internetit të QKEV-së: www.qkev.gov.al.

QKEV

Rr. Aleksander Moisiu”, Nr 80

Tiranë

Tel: 04 2452286

Email: info@qkev.gov.al

Reportazh

GRUAJA E PARË, Qamilja:
Kemi kaluar një jetë të mrekulueshme me Dalipin, me Feridenë me fëmijët tanë. Kaq di të them. Tani jam në një moshë që gjithë ditën rri në krevat, por shqyrr barkun e kam plot...

LIBRAZH

NGA ZENEPE LUKA

Për gjatë karrierës prej katër dekadash, nuk isha ndeshur me një histori të tillë, që e mësova rastësisht. Por nuk mbeti thjeshtë një intervistë, kishte gjëra interesante, që nuk ishin thënë kurrë. Historia e familjes, rruget që kalonte nëpër përrenj, ndërtuar nga një francez, që i vuri emrin e gruas Katerinë, makina e "KFOR", që transportonte deri në 20 vetë, sidogë kishte katër vende dhe deri tek rrëzimi im mbi një gur, duke përshkruar disa orë në këmbë mes dhimbjesh, mbështetur në një shkop.


RASTËSIA, MBRETI I BOTËS

Ndodhesha në Librazhd, në qytetin tim, së bashku me familjen. Për disa ditë qëndruam në hotel "Bardhoshi" buzë Shkumbinit. Kryem adetet tona, vendosëm lule tek varret e njerëzve tanë të dashur, babait, nënës, vëllait Beqirit, e pas disa ditëve emalëse, u bëmë gati të ktheheshim. Teksa po



pija kafen përpara nisjes, Havaja, një bashkëbiseduese imja më rrëfen si rastësisht tekta flisnim për vështrësitë e mbijetesës; Kemi pasur në fshat një farë Dalip Brahja, ustai i fshatit i thoshim. Kishte dy gra, bëri 25 fëmijë. Ata vërtetë ishin të varfër, por ndjeheshin të lumtur, sepsishtëpinë e kishin plot.

Kafja më mbeti në gysëmlartësi... Nuk e dhashë veten, por mendja nisi të punonte flur. Dy gra në kohën e Enverit, 25 fëmijë?! Udhëtimi i kthimit duhej të priste. E ngacmova edhe pak Havanë për këtë histori, me mendimin e palëkundur se do të nisësja menjëherë për në Librazhd-Katund...Një fshat i thellë, mes maleve, i harruar edhe nga Zoti, siç thonë. Dalipi kishte vdekur, kishte pesë vjet por në fshat ishte gruaja e tij e dytë, Ferideja. Kjo më interesonte e...



NË FOTO:
(Majtas)
Ferideja me një nga mbesat (Djalhtas) Gratë vazhdojnë të bëjnë punën e burrave (foto e vogël) Ferideja duke përcjellë gazetaret



Historia e Dalipit me dy gra, 25 fëmijë, 100 nipër e stërnipër

Në Librazhd –Katund, një udhëtim "epik" me makinë të "KFOR" mes maleve, rrëpirave, shtigjeve dhe varfërisë

ME MAKINËN E "KFOR"...

Për t'u ngjitur lart, vendast më thanë se vetëm një mjet shkon e vjen dhe shoferi, Bajram Allkja, u përgjigjet kërkesave të bashkëfshatarëve për t'i zbritur e ngjitur në fshat. Kontaktova në telefon dhe ai u tregua dashamirës.

-Kam rradhën për të vaditur arën sot, por duhet t'ju ndihmoj, pse vini për herë të parë në këto anë, më tha. Bukuri...

Pas 60 minuta pritjeje, erdhi mjeti. Hodha një sy brenda...Dukej si një makinë e ngritur nga varrezat që i kishte shpëtuar rrëmbyesve të skrapit.

-Kjo është makina?- e pyes. Po, ejani, nuk dua të vonohemi, shpejtoi përgjigja. Ndoshta nuk duhet të prisja luks, por duke ecur nëpër asfalt mund edhe të harrosh se sijeton pjesa tjetër...

Me fytyrë paksa të thartuar, të pushtuar nga ankthi, nisim të përpjetën nën uturimën e makinës, që gulçonte gjithë kohën, ca për shkak të moshës dhe amortizimit, por edhe për shkak të rrugës, pse gjithë kohën shoferi ecte me ridoto.

-Rëndësi ka motorri, jo llamarinat, na thotë ai, pasi konstatoi habinë tonë në pasqyrë.

Deri në një farë vendi, rruga dukej

normale si të gjitha rrugët rurale, por kur filluam të kalojmë përrenj të tharë e gurë zalli, na zuri frika. Shoferi e konstatoi menjëherë dhe na drejtohet:

-Mos kini frikë, unë kam 15 vjet me këtë makinë, është nga ato që përdor KFOR-i, kam po kaq vite që e bëj këtë rrugë. Nuk më ka ndodhur gjë edhe në dimër kur bora shkon deri 40 cm. Unë ju kam respektuar sot se vini për herë të parë këndej dhe kam marrë aq veta sa vende ka makina, por e dini ju që unë marr deri në 20 veta?

Çfarë?!-gati thirra.

Po, vazhdoi ai i qetë, rrinë mbi

njëri tjetrin, duket e pabesueshme por qëndrojnë edhe jashtë dverve duke u kapur fort tek ai katrori i hekurt që është sipër. Më vjen keq t'i lë bashkëfshatarët e mi këtu, kanë halle. Në këmbë duhet të paktën tre orë të mira që të shkosh deri në shtëpinë e fundit.

RRUGA E FRANCEZIT ME EMRIN E GRUAS SË TIJ

Gjatë këtij udhëtimi të pazakontë për ne, por të përditshëm për dhjetëra shqiptarë të tjerë, mësova edhe historinë e kësaj rruge, që për fshatin ishte një ndihmë e madhe. Barjami e di

Gruaja e dytë, Ferideja:

Qamilen si moshë e kasha si nënë, por shkonim si motra. Po edhe Dalipi e mbante kandinin drejt, nuk ia hante hakun asnjëherë. Një natë flinte me mua, një natë me atë...

mirë, madje ka qënë pjesë e festës kur u vendos një pllakë dhe ne befasonemi me atë që ai rrëfen.

Kjo rrugë nuk ka ekzistuar deri në majë, por falë humanizmit të një francezi që e solli, kështu si është deri atje. "Një djalë nga fshati ynë, Altin Bala quhet, ka ikur prej vitesh emigrant në Francë. Para tre vjetësh në shtëpinë e tij këtu në fshat vjen pronari i tij dhe u befusua me kushtet e fshatit, mungesa e rrugës. Kur shkoi në Francë mblodhi ndihma, ndoshta 50-60 mijë euro, pagoi një firmë nga Elbasani dhe bëri këtë rrugë përmes malesh. Në kryqëzimin u vendos një pllakë, ku shkruhej emri i rrugës, "Katerina", që ishte bashkëshortja e francezit. Fatqësisht



“Guri i mallkuar”

Gruaja e parë e Dalipit, në moshë të madhe, por e lumtur

Kënaqësia e kësaj interviste të veçantë, nuk do të vazhdonte gjatë tek unë. Në rrugën që duhet të përshkoja në këmbë, shkava dhe dëmtova meniskun e gjurit. Ngelur në mes të pyllit, mbështetur në një shkop thane, m'u desh të eci me orë të tëra duke përjetuar dhimbje të forta deri sa të mbërrija në kryqëzimin ku vinte makina. Megjithë mjekimin, kjo dhimbje evitohet vetëm me ndërhyrjen kirurgjikale, më tha mjeku, profesor Panajot Boga. Kështu e mbylla në fshat historinë e Dalipit të vdekur me 25 fëmijë, duke u bërë “e çalë”.

Pors'mund ta lija me kaq. Mungonte gjysma tjetër e Dalipit, Qamilja. Këmba më pengonte të vazhdoja aventurën për të plotësuar këtë

histori, por telefoni ma zgjidhi problemin. “Kemi kaluar një jetë të mrekullueshme, të paharruar me Dalipin, me Feriden, me fëmijët tanë. Kaq di të them, tani jam në një moshë që gjithë kohën rri në krevat, por shyqyr Zotit e kam barkun plot”, më thotë me një zë të lodhur gruaja e parë e Dalipit nga Librazhdi.

Bisedën e vazhdojmë me Dashamirin, djalin e fundit të Qamiles, që jeton në qytet prej 20 vitesh. Ai thotë se e di historinë e familjes së tij dhe ndjen krenarë për babanë e tyre, për motrat dhe vëllezërit, që kanë mbushur një lagje.

Dashamiri ka trashëguar zanatin e të atit dhe i shërben qytetit me dyqanin që ka celur në afërsi të Stacionit të Trenit.



NË FOTO:
Zenepe
Luka pas
aksidentit

ME NISKU

Një shkop thane bëhet bashkëudhëtar për disa orë i Zenepe Lukës, derisa arrin në kryqëzimin ku vinte makina. Shkak këputja e meniskut nga rrëzimi në gur

ajo është hequr dhe kan mbetur vetëm korniza prej hekuri. Kjo tregon mosmirënjohje, por ndoshta e kanë marrë për ta shitur”, tregon Barjami.

“Thonë se Francezi synon të shfrytëzojë një masiv argjili në mal dhe gjënë e parë që do të bëjë është asfaltimi i rrugës. Nëse e bën këtë, portretin e tij do ta derdhim në bronx, sepse nuk kemi asnjë shpresë nga shteti, gjithë kohën kemi qënë të harruar”, vazhdon ai me fshatin që ëndërton një frances duke investuar.

HISTORIA MES MALESH E DALIPIT

Historia e familjes së Dalip Brahjes, ka mbetur aty mes malesh, e njohin vetëm bashkëfsharët dhe të afërmit. Ndoshta për shkak të largësisë nuk ka qënë e mundur të shkruhet qoftë edhe disa rrjeshta për rastin, që për të veçantë që ka, mund të futet në librin Gines, atë shqiptar sigurisht...Mbërrinjë më në fund...

Feride Braha është 62 vjeçe, nusja e dytë e Sadikut. Pa asnjë ndroje se kjo histori do të bëhet publike, me vërtetësi dhe humorin që e karakterizon, pranon të tregojë historinë e saj, historinë që na sollti në këto thellësi.

Në çfarë rrethanash je martuar me Sadik Brahjen?

Kam qënë 15 vjeçe, kam qënë vajzë e bukur, mos më shih sot që jam bërë gyshe. Një ditë shkova të mpirhja një vegël tek ai, Dalipi, ka qënë ustai i fshatit dhe në një çast ma bëri me sy. Kur shkova ta marr veglën, më tha se do të më merrte nuse. Ti je i martuar, i thashë, ke edhe fëmijë. Le të jem, m'u përgjigji, ti do të jesh nusja e vërtetë, shpirti i


Dalipit. Ishte burrë i pashëm, punëtor, por edhe sevдали i madh. M'u mbush mëndja dhe shkova, u bëra gruaja e tij, nisa një jetë të re, të pazakontë.

Cilat ishin marrdhëniet me gruan tjetër, që ishit në një çati?

Si moshë e kisha si nënë, por me Qamilen, megjithëse kishim një burrë të përbashkët, shkonim si motra. Shkonim mirë se edhe Dalipi e mbante kandarin drejt, nuk ia hante hakun asnjëherë. Kishim një harmoni, që nuk e kish familje tjetër në fshat.

Çdoni të thoni që e mbante kandarin drejt, nuk ua hante hakun...?

Megjithëse unë isha shumë e re, me mua kish bërë martesën zyrtare, na trajtonte njësoj. Flinte një natë me njëherë, një natë me tjetrën. E dinim rradhën dhe i lëshonim vendin njëra tjetrës. Të dya mbeteshim shtatzanë, ka pasur raste që kemi lindur të dya njëherësh, madje kemi bërë edhe një çift binjakësh.



NË FOTO: (Lart) pamje nga fshati Librazhd-Katund



Sa fëmijë keni lindur?

Unë Feridja kam lindur 13 fëmijë, në mos gabohem Qamilja ka lindur 12 fëmijë, pra Dalipi ishte babai i 25 fëmijëve. Gjatë jetës më kanë vdekur katër fëmijë dhe sot kam gjallë 9, gjashtë vajza dhe tre djem. Kam një taborr me nipër e mbesa, e vetmja pasuri që më ka lënë Dalipi.

Si ushqehet kjo familje e madhe me 25 fëmijë?

Nuk mbetej askush pa qorrenë, Dalipi ishte usta i Zoti dhe ia dilte mbanë. Nuk kishte gjë më të bukur kur shihje fëmijët në sofër që hanin përshesh me qumësht në tepsit dhe më pas kërreste luga kokës. Të krijohej përshypja se ishte kopështi i fshatit, unë dhe Qamilja edukatore, ndërsa Dalipi ishte kryetari i familjes.

Jeni grindur ndonjëherë me Qamilen, po fëmijët me njëri tjetrin?

Nuk mund ta besoni, por asnjëherë nuk kemi grindur, ishim pjesë e familjes.

Ju thashë Dalipi e mbante kandarin drejt, nuk i hynte asnjëherë në hak. Po të jetë i zoti i shtëpisë korrekt, nuk kanë problem gratë apo fëmijët. Fëmijët me njëri tjetrin grindeshin si fëmijë, por kur u rritën ata e donin edhe më shumë njëri tjetrin. Kjo vazhdon edhe sot, ata janë vëllezër e motra dhe bëhen shumë, shkojnë e vijnë, sidoqë janë larguar, vajzat janë martuar dhe djemtë kanë ikur në emigrim. Jo vetëm fëmijët por edhe nipërit e mbesat, stërnipërit dhe stërmbesat, që janë bërë 100, takohen me mall dhe ndihmojnë njëri tjetrin që ka nevojë. Janë fëmijët dhe pasardhësit e Dalip Brahjes, që ishte një copë burrë.

Si ishte e mundur bashkëjetesa me dy gra në kohën e regimit, si nuk është dënuar burri juaj?

Celebrimin e kishte bërë me mua, pra zyrtarisht një grua kishte, por ju thashë ishte një copë burrë, ustai i fshatit dhe kishte kredi. Pastaj nuk krijonim problem, ishim familje e rregullt. Shteti nuk kish ndonjë të keqe prej nesh, bënim fëmijë, shtonim popullsinë. Dalipi i shërbente kooperativës natë e ditë dhe i kishte bërë vend vetes. Sherre nuk kishim, pse mos na linte në hallin tonë. Pastaj Dalipi i kishte shokë ata të partisë, që i rihnin

shpatullat se ai mbante kooperativën me vegla.

Çfarë ndodhi në familjen tuaj pas rënies së regimit?

Qamilja me fëmijët e saj iku nga fshati, është sistemuar në qytetin e Librazhdit, kurse unë me fëmijët e mij dhe Dalipi mbetëm këtu, në shtëpinë tonë, ku ngrysem një jetë bashkë. Dalipi ndërroi jetë përpara 6 vjetësh dhe në atë ditë të dhimbshme u bashkuam sërish bashkë: Dy gratë, fëmijët, nipër dhe mbesa. Unë jetoj me djalin e vogël Rudin, kurse Qamilja me djalin e vogël të saj, Dashamirin. Shkojmë e vijnë tek njëra tjetra, më shumë unë se Qamilja është e sëmure dhe i ka kaluar të tetëdhjetat. Ja kështu vajti jeta jonë, me varfëri, por kishim barkun plot.

Të ndihmojnë fëmijët ekonomikisht?

Bereqaves, tani një njeri jam dhe kursejnë për nënën e tyre. Jam e lumtur, ja sapo më erdhi mbesa, do të zbris në qytet të marr një mbesë tjetër 4 vjeçe, e kam të vajzës. Kjo më bën të lumtur. Njeriu një jetë ka. Për Dalip Brahjen, gratë e tij, fëmijët e pasardhësit, nuk flet kush keq. Na kanë nderuar fëmijë edhe në emigracion, punojnë për familjet e tyre, por kurrë nuk harrojnë nënat, fshatin.

Çfarë kushte i janë krijuar gruas sot në fshat, Feride?

Asgjë nuk ka ndryshuar, çfarë ndihmojnë fëmijët. Gruaja ngarkohet si dikur, bën punët në arë, që nga mbjellja, vaditja, korria. Është fshat i thellë, mungon rruga, ka varfëri. Nuk duhet harruar vetëm një fakt që pas ikjes së fëmijëve në emigracion, gratë, nënat, panë lekun me sy, vishen dhe ushqehen më mirë, por edhe shtëpitë janë rregulluar ndryshe. Shumë familje dhe janë larguar në Librazhd dhe qytete të tjera...

NJË PENG I MADH

Në këtë reportazh ku zë vënd historia e Dalip Brahjes nga Librazhd-Katundi, padyshim ishin të domosdoshme fotot e Dalipit me gratë, me fëmijët. Dashamiri u shpreh se fotot i kishte vëllai i vogël dhe që të shkosh deri atje, përveç vështirësive që ka rruga, duhet të humbasësh edhe kohë. Ai nuk shkoi...Ndoshta nuk kishte pse shihet në gazetë, diçka që e shihet çdo ditë...



Intervista

TIRANE

FERNADA CENKO

Juristi dhe kreu i PUK, Idajet Beqiri ka dhënë rrugët juridike se si Shqipëria dhe Kosova mund të drejtohen OKB-së për shfuqizimin e Konferencës së Londrës, duke na rikthyer kufijtë e Shqipërisë Natyrale.

Kryetari i Listës për Shqipëri Natyrale, Koço Danaj, do mbledh 100000 nënshkrime nga shqiptarët që përkrasin idenë e bashkimit të «Shqipërisë Natyrale» dhe këtë listë do t'ju dorëzojë qeverive të shumta, përfshirë atë gjermane, britanike dhe austriake. Si e vlerësoni këtë nisim?

Është një ide e mirë. Angazhime të tilla i shërbejnë vazhdimësisë së punës dhe përpjekjeve për realizimin e bashkimit të trojeve etnike shqiptare me shtetin amë. Pas Kongresit famëkeq të Berlinit, i cili i coptoi keq territoret e Shqipërisë, duke ua dhënë fqinjëve grabiçar, nuk kanë mësuar asnjëherë përpjekjet e shqiptarëve për ribashkimin e kombit të ndarë. Platforma e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, e cila ka bërë amanet dhe ideal të çdo shqiptari realizimin e bashkimit kombëtar, ka qënë dhe ka mbetur për një shekull e gjysëm me radhë udhërrëfyes për ne. Forca e parë politike, pas vendosjes së pluralizmit politik në Shqipëri në vitet '90', e cila e përqafoi dhe e bëri ide të vetme themelore të programit të saj ribashkimin e trojeve etnike shqiptare, në një shtet të vetëm, është Partia e Unitetit Kombëtar. Ka plotë 22 vjet që kjo forcë politike i është përkushtuar kësaj ideje dhe që ka siguruar arritje të mëdha. Kordinimi i punëve dhe veprimeve të disa lëvizjeve të mirëfillta politike, intelektuale dhe kombëtare andej dhe këtej kufijve të padrejtë politik, bëri realitet krijimin e katër ushtrive çlirimtare shqiptare, sikurse ishin UÇK, UÇPMB, UÇK e shqiptarëve nën Maqedoni si dhe AKSH, të cilat me luftën e tyre të drejtë, fituan simpatinë e NATO-s dhe krijuan një realitet të ri për shqiptarët në Ballkan. Fal këtyre lëvizjeve sot kemi një republikë të dytë shqiptare në Ballkan, sikurse është Kosova shtet i pavarur. Kështu që një pjesë e çështjes sonë kombëtare u zgjidh. Por ka mbetur ende punë për të bërë. Tashmë, krahas PUK, kanë lindur edhe lëvizje të tjera, siç është "Lista Për Shqipërinë Natyrale", Lëvizja Vetvendosja, Aleanca Kuq e Zi, PDIU, Aleanca Popullore etj. Gjithsejçila prej tyre, pavarësisht këndvështrimeve që kanë, në fund të fundit kanë një gjë të përbashkët, punën dhe luftën për zgjidhjen në tërësi të çështjes kombëtare shqiptare. Parë nga ky këndvështrim nisim i Listës Për Shqipërinë Natyrale i shërben avancimit të idesë së krijimit të shtetit të bashkuar shqiptar në Ballkan.

Sa ka qënë kjo Shqipëria etnike dhe si, pse dhe ku hazohet fakti që shtete të tjera fqinje janë shtuar me territore shqiptare?

Copëtimi i Shqipërisë Etnike, faktikisht është rrjedhim i ndeshjes së dy civilizimeve, civilizimit të krishterë dhe atij islame. Këto dy civilizime u ballafaquan përgjithshëm gjatë Kriszës Lindore

me epilogun tragjik të Luftës Ruso – Turke të viteve 1877-1878. Kjo Kriszë u mbyllë me Traktatin e Kongresit të Berlinit, i cili ju imponua Perandorisë Osmane nga Gjermania, Franca, Anglia, Austro-Hungaria dhe Italia për interesat e Rusisë. Evropa dhe Rusia e dënuan kombin shqiptar, duke e ndarë në disa shtete për të copëzuar aftësitë dhe mundësitë e tij natyrore, gjeostrategjike, politike, ekonomike e ushtarake për zhvillimin unik të tij. Njësi etnokulturore e gjeopolitike e Shqipërisë në kuadër të Perandorisë Osmane nga mesi i shekullit XVII, ka pasur një territor rreth 120.000 km2. Kur u krijuan shtetet e Malit të Zi, të Serbisë dhe të Greqisë, Shqipërisë ju grabitën rreth 5.000 km2 territore të banuara kryesisht me shqiptarë ortodoksë. Nga 115.000 km2 territor etnokulturore e gjeopolitike që kishte Shqipëria në kuadër të Perandorisë Osmane, me rreth 2.800.000 banorë, Traktati i Berlinit i 13 korrikut 1878 i shkëputi Shqipërisë Etnike 24.458

Duhet që ti popullojmë me shqiptarë të gjitha trevat shqiptare. Kudo ku janë shqiptarët të kemi ligje të njëjta, institucione të njëjta, njësimet gjuhe, ekonomi të përbashkët etj

km2 territore, duke zgjeruar Serbinë me 10.500km2, Greqinë me 9.275 km2 dhe Malin e Zi me 4.683 km2. Mirpo Konferenca e Ambasadorëve e Londrës nuk pranoi asnjë kërkesë shqiptare për njohjen e Shqipërisë në shtet dhe saj etnike dhe historike dhe krijoi një "Shqipëri" më të vogël se një e treta pjesë e Shqipërisë Etnike. Me



NË FOTO: Avokati Idajet Beqiri

Shqipëria dhe Kosova në OKB për kufijtë Shqipëria etnike, një realitet i padiskutueshëm



Harta e Shqipërisë etnike

Traktatin e Londrës, Serbia u zgjerua me 34.000 km2 tokë shqiptare, Mali i Zi me 7.000 km2 shqiptarë, Greqia u zgjerua me mbi 20.000 km2 troje shqiptare.

Kur u krijuan shteti shqiptar më 28 nëntor 1912 për çfarë sipërfaqe territoriale dhe për cilat territore bënte fjalë Deklarata e Pavarësisë?

Kur u mbledh Kuvendi Kombëtar i Vlorës më 28 Nëntor 1912, Shqipëria ishte e pushtuar prej vendeve Ballkanike. Ismail Qemali dhe burrat e shquar të atij Kuvendi i shpallën Pavarësinë e Shqipërisë dhe e formuan shtetin kombëtar, jo në emër të atij territori të ngushtë që kishte mbetur ende i lirë e i papushtuar nga shtetet ballkanike (që shtrihëj në hapësirën Vlorë – Lushnje – Berat – Gjirokastrë), as edhe në emër të atij shteti të cunguar që do të njihete më vonë Konferenca e Londrës e vitit 1913, shtet të cilin e trashëgojmë ne sot, por në emër të të gjitha trevave e të gjithë popullsisë shqiptare. Kuvendi i Vlorës dhe Qeveria e Përkohshme që doli prej tij, nga përbërja e tyre përfaqësonin thuajse të gjitha viset shqiptare, duke përfshirë edhe ato që

ishin pushtuar nga ushtritë e vendeve ballkanike, gjë që i dha këtij kuvendi karakterin e një Asambleje mbarëshqiptare. Midis 63 delegatëve, 16 ishin nga Kosova, nga kryeqendra e saj Shkupit dhe nga qytetet e tjera, ndërsa 7 ishin nga Çamëria. Në deklaratat që u bëri Fuqive të Mëdha qysh më 28 dhe 29 nëntor të vitit 1912, Ismail Qemali jo pa qëllim e vuri theksin në këtë realitet, duke deklaruar se Shpallja e Pavarësisë dhe formimi i Qeverisë së Përkohshme ishin veprë e Asamblesë Kombëtare, ku morën pjesë përfaqësuesit e të gjitha viseve të Shqipërisë, pa dallim feje e krahine. Kuvendi dhe Qeveria e Përkohshme morën përsipër detyrën historike të zgjidhjes së plotë të çështjes kombëtare. Si në Memorandumin që delegacioni shqiptar paraqiti kryetarit të Konferencës së Londrës, Eduard Grejt, më 2 janar të vitit 1913, ashtu edhe në takimet që Ismail Qemali pati me personalitetet e shteteve të ndryshme në Londër, Qeveria e Përkohshme mbrojti kërkesat e ligjshme

Qeveria e Vlorës u kërkoi Fuqive të Mëdha që, krahas me Pavarësinë e plotë "ti njiheshin Shqipërisë homogjeniteti i saj i jashtëm, kufijtë e saj natyrorë

të popullit shqiptar për të patur shtetin e vet kombëtar e të bashkuar. "Populli shqiptar, - thuej në këtë dokument, - si grupim etnik më kompakt, më homogjen dhe më i rëndësishëm në Gadishullin Ballkanik kishte të drejtë të themelonte shtetin e vet të bashkuar kombëtar".

Qeveria e Vlorës u kërkoi Fuqive

RRUGA e vetme ligjore do të ishte që dy shtetet shqiptare, ai i Shqipërisë dhe i Kosovës, së toku, ose veçmas, t'i kërkonin Gjykatës së Drejtësisë së OKB në Hagë zgjidhjen gjyqësisht të kësaj padrejtësie

të Mëdha që, krahas me Pavarësinë e plotë "ti njiheshin Shqipërisë homogjeniteti i saj i jashtëm, kufijtë e saj natyrorë, që diktohen sa nga rrethanat etnike të kohës së sotme, aq edhe nga të drejtat që i takonin popullit shqiptar si banues i hershëm i këtyre territoreve" si dhe që t'i ktheheshin e t'i lësheshin Shqipërisë të gjitha trojet shqiptare të pushtuara nga Serbia, Mali i Zi e Greqia, siç ishin Kosova, Dibra e trevat e tjera lindore të Shqipërisë dhe Çamëria në jug të vendit.

Kreu i Listës për Shqipërinë Natyrale përmes nënshkrimeve të mbi një milion shqiptarëve në peticionin që ka përgatitur kërkoi të shfuqizojë vendimet e marra nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër? Sa i mundur është ky veprim?

Besoj se nuk është ky objekti i këtij peticioni. Nuk mund të ndryshohet një traktat ndërkombëtar, sikurse është Traktati i Londrës i 1913 me peticione, sado i madh të jetë numri i nënshkrimeve në të. Coptimi i Shqipërisë në Konferencën e Ambasadorëve në Londër në vitin 1913 është bërë përmes një marrëveshje ndërkombëtare të pesë fuqive të mëdha të kohës. Kjo Marrëveshje, në kohën që u morë, për nga të gjithë elementët e saj përbërës ishte e pa drejtë, e pa ligjëshme, antihumane, çnjerëzore, diskriminuese ndaj një kombësie të tërë, por që në fund të fundit i miratua, u nënshkrua, e zbatua dhe u ratifikua. Marrëveshjet ndërkombëtare kanë fuqinë e ligjit për shtetet që janë palë në këto marrëveshje. Me falë të tjera, marrëveshjet ndërkombëtare krijojnë të drejta dhe detyrime për shtetet palë. Në rënditjen e burimeve juridike të përcaktuara në nenin 38 të Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, marrëveshjet ndërkombëtare janë të renditura të parat. Ka një sërë faktorësh politik dhe juridik që e bëjnë të vështirë shfuqizimin e Traktatit të Londrës. Rruga e vetme ligjore do të ishte që dy shtetet shqiptare, ai i Shqipërisë dhe i Kosovës, së toku, ose veçmas, t'i kërkonin Gjykatës së Drejtësisë së OKB në Hagë zgjidhjen gjyqësisht të kësaj padrejtësie. Mirpo edhe sikur t'a bënim për vete Gjykatën e Hagës dhe t'a fitonim gjyqin, ekzekutimi i këtij vendimi gjyqësor, domethënë marrja e trojeve shqiptare Serbisë, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Greqisë dhe kthimi i tyre Shqipërisë, do të bëhej kur Këshilli i Sigurimit unanimisht të binte dakord për t'a ekzekutuar këtë vendim me forcat ushtarake shumëkombëshe. Në se vetëm një anëtar i KS të OKB do të vendoste veton për të mos u ekzekutuar ky vendim i Gjykatës së Hagës, ky vendim gjyqësor do të mbeste në sirtar pa u zbatuar.

Nëse as kjo s'ka zgjidhje?

Atëherë, duhet që ti popullojmë me shqiptarë të gjitha trevat shqiptare. Kudo ku janë shqiptarët të kemi ligje të njëjta, institucione të njëjta, njësimet gjuhe, programe, ekonomi të përbashkët etnike, arsim, shkencë e kulture të njëjta, thyerje kufijsh me martesat etj. Trevat tona në Çamëri ti popullojmë me çamët që janë përzënë me dhunë. E kështu hap pas hapi ndryshimet të lloshore do të bëjmë ndryshime sasore.



**Kriza siriane
forcon dollarin, euro
shënon rënie në treg**

Leu e ka mbyllur javën në vlerësim ndaj Leuros duke regjistruar një nivel më të lartë ditën e premte. Euro e nisi javën në kuotën e 140.24 lekëve dhe e mbylli në kufijtë e 139.98 lekëve. Rënia e euros ka ardhur në radhë të parë si pasojë e zhvlerësimit të kësaj monedhe në bursat ndërkombëtare. Ekspertët e këmbimit valutës shpjegojnë se situata në Siri dhe

përgatitja e trupave ndërkombëtare për të ndërhyrje atje ka çuar në forcimin e dollarit në treg gjatë javëve në vazhdim. Një efekt negativ në vlerën e euros ka dhënë edhe kërkesa e ulët nga bankat në vend për të këtë monedhë. Sipas agjentëve, bankat nuk po blejnë aktualisht monedhë të përbashkët për nevoja të klientëve të tyre apo të brendshme. Megjithatë, nuk duhet

të presim një euro më të ulët se 139.5 lekë dhe më të lartë se 141 lekë. Brenda këtyre dy kufijve pritët të luhatet monedha e përbashkët në muajt në vazhdim. Ndërkohë dollari ka shënuar një performancë pozitive në këmbimet me lekun, si pasojë e zhvillimeve në bursat ndërkombëtare. Ai e nisi javën në kuotën e 104.95 lekëve dhe e mbylli në 105.71 lekë.

Qeveria në ikje uli taksat para zgjedhjeve

**“Ligjet elektorale”
kosto 78 mln euro**

“Dhuratat” nuk e shpëtuan dot Berishën

LAJME SHKURT

■ **IFC financon ndërmarrjet e mesme e të vogla**
Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC), anëtare e Grupit të Bankës Botërore, ka dhënë një financim në formën e një linje krediti tregtar, që synon rritjen e aksesit në financim të ndërmarrjeve të vogla e të mesme. Me linjën e re të kreditit prej 4 milionë dollarësh, Union Bank do të zgjerojë mbështetjen financiare për klientët e saj, korporatave dhe biznese të vogla, të angazhuara në tregtinë ndërkombëtare.

■ **Eurozonë, pa ndryshim niveli i papunësisë**
Përqindja e papunësisë qëndroi e pandryshuar në zonën euro gjatë muajit korrik, në krah të mesazhit të qershorit e këtij viti, por duke mbetur ende në nivelin rekord prej 12.1 përqindësh. Kjo është bërë e ditur sipas shifrave zyrtare mbi punësimin në eurozonë. 19.2 milionë persona ishin të papunë në eurozonë, ose 15.000 më pak se në qershor, theksoi Eurostat.

■ **Zvicër-SHBA, marrëveshje për depozitat bankare**
Ministria zvicerane e Financave, Eveline Eidmüller-Schlumpf deklaroi dje se Zvicra ra dakord me Shtetet e Bashkuara të Amerikës për çështjen e asetëve të padëklaruar të qytetarëve amerikanë të depozituara në bankat zvicerane. Marrëveshja e nënshkruar dje në Washington përfundoi pas tre vjet negociatash të stërgjatura ndërmjet Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Zvicrës.

LAJMI

Me kërkesë të FMN, ministria e Financave ka dhënë informacion lidhur me efektin në buxhetin e shtetit të ndryshimeve ligjore, të kryera para zgjedhjeve nga mazhoranca. Sipas saj, “goditja” e arkës së shtetit ka qenë në masën 11 mid lekë

TIRANE

GENC KONDI

Nismat e ndërmarrjeve nga qeveria Berisha në përpjekje për të përmirësuar marrëdhëniet e acaruar me biznesin, para zgjedhjeve parlamentare, kanë patur një efekt negativ në buxhet rreth 11 miliardë lekë ose 78 milionë euro. Kjo del nga përgjigja, që ministria e Financave i ka dhënë Fondit Monetar Ndërkombëtar për këtë çështje.

Kështu, nga ligji për taktimin mbi të ardhurat, ndryshimet parashikojnë që të ardhurat nga paga dhe bonuset nga 0-30,000 lekë të mos jenë të taksueshme dhe pagat mbi këtë nivel të taksohen 10% të pagës bruto. Ligji ka hyrë në fuqi më 1 maj 2013 dhe ndikimi negativ tek të ardhurat, për periudhën qershor-dhjetor 2013 vlerësohet 1.5 miliardë lekë. Fermerët përjashtohen nga pagesa e taksës prej 10% në transakcionet e shitjes së tokës.

Ligji ka hyrë në fuqi në prill 2013. Një parashikim i saktë i të ardhurave është i vështirë të bëhet, teksa mbledhja e kësaj takse varet nga transakcionet e tokës. Vlerësohet se ndikimi negativ tek të ardhurat i kësaj takse është 300 milionë lekë për 2013-n.

Ndryshimi për TVSH-në parashikon përjashtimin e pagesës së TVSH-së për importet e makinerive dhe pajisjeve që përdoren për investime të mëdha (për investime që fillojnë nga 50 milionë lekë e më lart); përjashtim nga TVSH për makineritë dhe pajisjet e importuara në industrinë përpunuese, agrobiznes dhe bizneset që janë subjekt i taksës së biznesit të vogël, gjithashtu dhe përjashtimet për pagesën për TVSH-në e hekurit dhe çimentos së importit ose vendas që përdoret si lëndë e parë në ndërtimin e hidrocentraleve. Ndikimi i vlerësuar ka qenë



Selia e FMN në Washington

4 miliardë lekë. Ndërkohë, ndryshimet e fundit, të bëra në ligjin e taksave kombëtare që lidhen me përgjysimin e taksës vjetore

për automjetet e përdorura kanë një efekt negativ që llogaritet në gjashtë miliardë lekë për gjithë vitin 2013. Ministria e Financave i ka

kthyer përgjigje FMN-së edhe në kuadër të auditit të financave publike, i cili do të ndodhë në muajt tetor-nëntor. Në kushtet kur qeveria është në detyrë, shumë përgjigje kanë mbetur pezull, duke ia lënë në dorë ministrit të ri, Shkëlqim Cani. Duke nisur nga deficieti buxhetor, ulja e borxhit, shpenzimet, etj., për qeverinë aktuale nuk bën më sens që të tregojë se çfarë duhet të bëjë, ndërsa mësohet se, sipas parashikimeve, nisur nga treguesit e 7-mujorit, buxheti do t'i mungojnë 30 miliardë lekë ose 215 milionë euro.

Energjetika

CEZ prezanton risitë e shërbimit për klientët e saj

Drejtori i CEZ Shpërndarjeje, Sait Dollapi, ka shpjeguar në një konferencë për shtyp të premten sistemet inovative që ka zbatuar kompania muajt e fundit në drejtim të sistemit të faturimit, faturave online, sistemit të ankesave, dërgimit të faturave. Sipas tij, ndërkohë që sistemi i faturimit (Billing), që më parë merrej shërbim dhe mirëmbahet nga kompani e huaj, tani mirëmbahet dhe zhvillohet nga departamenti i teknologjisë dhe informacionit në CEZ. Janë përmirësuar modulët e sistemit ku vëqohen: përlogaritje automatike e debisë



Sait Dollapi

dhe kamatës në kohë reale, detajimi dhe shfaqja e dallueshme e të gjithë informacionit (faturim, arkëtim), zhvillim dhe integrim i sistemit të ankesave në sistemin billing. Është rikonceptuar procesi i gjenerimit dhe printimit të faturave, me qëllim shmanjen e vonesave.

Heshtja

Qeveria në ikje u shmanget përgjigjeve

Endarë në dy kapituj, Politika Fiskale dhe Reforma Strukturore, zyrtarët e FMN-së kanë kërkuar, përmes pyetjeve, të mësohet rreth ndryshimeve të taksat dhe efektet në buxhet, çfarë po bëhet për ekonominë informale, si do të jetë në të ardhmen ecuria e borxhit, deficitit, madje nuk kanë harruar të pyesin ministrin Ridvan Bode edhe për sektorin energjetik. Temat më të nxehta nuk kanë marrë përgjigje dhe FMN-ja duhet të presë ministrin e ri të Financave, për të mësuar rreth politikës që do të ndiqet në të ardhmen. Praktikant e lënies pezull të disa pyetjeve, qeveria e re i ka cilësuar papërgjegjshmëri dhe mungesë serioziteti.

Blije atë që të duhet!

KËRKOJ APARATE FOTOGRAFIK METALIK TË VJETËR

Tiranë, kërkoj të blej Aparate Fotografik Metalik të vjetër. Koleksionoj aparate fotografike të vjetër të të gjitha markave. **TEL: 35569688088**

Shite atë që nuk të duhet!

Tregu më i madh në Shqipëri për shit-blerje

Për më shumë informacion na vizitoni në faqen tonë të website: www.MerrJep.al

IPHONE 5 FACTORY UNLOCK

Iphone 5 factory unlock i ardhur nga Italia shumë pak i përdorur as një muaj 16 gb i bardhë. **TEL. 0692401666**

PEUGEOT 206 BENZINË 1.1CC,

Shes Peugeot 206 motor 1.1cc benzinë me dokumenta të rregullta targa italiane. Makina ka 120.000 km, origjinale me 4 dyer, tapiceri super e pastër me goma të reja të sapo vëna me faturë HANKOOK, disqe alumini, kasefotoni mp3. **TEL. 0686803203**

EMISIONI MË ORIGINAL I SEZONIT

Nga e hëna në të premte 07:10

Ritransmetim 07:40 dhe 08:10

NË TELEVISIONIN

A1 REPORT!

Origjina e Lajmit



BUÇI



AKTORI



DEMOKRATI



MUZIKANTI



REGJISORI

Paçe me Gazeta

...DREJTON EMISIONIN ZERI I HERVIN ÇULIT

DIGITALB

TOKESORE
KANALI 48
Do na ndiqni në gjithë Shqipërinë

DIGITALB

SATELITOR
KANALI 50
Do na ndiqni në gjithë Shqipërinë, Maqedoni, Kosovë, Itali, Greqi dhe në pjesën tjetër të Europës

VALË UHF

NË PREFEKTURAT:
TIRANE - DURRES - LEZHE - FIER

ABCOM

ALBANIAN BROADCAST COMMUNICATION
KANALI 158

TOROSI I BB4

TAKON
AKTORIN
E FAMSHEM
NICOLAS CAGE



JAMES BIBERAJ

Nga Hollivudi
për herë të parë
në film shqiptar



WWW.SHQIPTARJA.COM

Suplementi i së shtunës të SHQIPTARJA.com

THASH&THEM

NR. 34 E shtunë, 31-08-2013


thashethem@shqiptarja.com

KENGETARJA

**Khensila: Fama nuk
më bën të lumtur**



**Rezarta Shkurta: Dua
që vajza t'i ngjaj Ermalit**



Klajda GJOSHA

**I JEP FUND
BEQARISE
SEKRETET
E DASMES ME
350 TE FTUAR**

Ministrja e Integritetit: Nuk dua të
më preket intimiteti i ceremonisë



Khensila MYRTEZAJ:

Fama nuk më bën të lumtur

Këngëtarja e talentuar vjen në një intervistë për këngën e saj më të re, e cila e ka sjellë Khensilën ndryshe dhe shpërthyes

JONIDA HITOVEZI

Ajo i ka ngjitur rrugët e karrierës të sigurta dhe sot është një ndër këngëtares e reja më të vlerësuara. Khensila Myrtezaj ka krijuar që në fillimet e karrierës një identitet të vetin si artiste. Fillimisht ishin baladat e ëmbëla të dashurisë, me të cilat ajo fitoi mjaft vëmendje nga publiku, e sidomos kur më pas historia e saj me aktorin e Portokallisë, Besi u bë zyrtare e pushtoi faqet e mediave rozë. Këtë herë Khensila vjen me një këngë më ritmike, që i shkon për shtat verës dhe fillimit të vjeshtës. Ka zgjedhur të provokojë me titullin "Liar" këtë herë, por ama vetë thotë se gënjeshtrat nuk i pëlqejnë fare, as në dashuri dhe as ato të

Ndihem mëse e shpërblyer. Nuk ka sadsifaksion më të madh se të jesh në skenë të vlerësoshesh, të motivohesh nga duartrokitjet dhe komentet pozitive

bardhat, të cilat i ka lënë qysh nga koha e fëmijërisë. "Unë nuk jam pro gënjeshtrës as në dashuri e as në asnjë aspekt tjetër jetësor. Nëse do gënjenim në dashuri do gënjenim veten, sepse partneri ose partnerja është gjysma jote", -thotë Khensila, e cila këtë herë vjen më shpërthyes se kurrë.

Khensila sapo ka dalë klipi yt i ri "Liar", me kë bashkëpunove këtë herë?

Kënga është kompozuar nga Elgit Doda, me të cilin vij edhe në bashkëpunim këtë herë. Teksti mban firmën e Rozana Radit dhe klipi është realizuar nga "Max production". Ndërsa sa i përket rrymës muzikore, kjo këngë ka ritme verore haue.

Suksesi për ty ka ardhur shpejt, i menjëhershëm... a të frikëson kjo gjë?

Jo. Aspak, pastaj nuk do të thoja që ka ardhur i menjëhershëm, sepse unë kam që fëmijë që merrem me muzikën. Q y s h

Gjithmonë jam munduar gjatë këtyre viteve që të hedh hapa të ngadalhtë, por të sigurtë



nga "Gjeniu i vogël" e deri tek "Ethet e së premtës" e deri më sot unë kam punuar shumë gjatë gjithë këtyre viteve me gjithë forcën dhe dashurinë që kam për muzikën. Gjithmonë jam munduar gjatë këtyre viteve që të hedh hapa të ngadalhtë, por të sigurtë. Nuk më tremb përderisa ky sukses që kam sot nuk më ka ardhur i menjëhershëm, por është kultivuar ndër vite.

Je identifikuar deri diku me balada të bukura dashurie. Këtë herë zgjedh të vish me një këngë për gënjeshtrë dhe gënjeshtrat. Mendon se të gjithë gënjëjmë nga pak, qoftë edhe në dashuri?

Të falenderoj për fjalët. Unë nuk jam pro gënjeshtrës as në dashuri e as në asnjë aspekt tjetër jetësor. Nëse do gënjenim në dashuri do gënjenim veten, sepse partneri ose partnerja është gjysma jote.

Gënjeshtra më e madhe që ke thënë ndonjëherë, qoftë nga fëmijëria, të kujtohet?

Do të gënjeja nëqoftëse do të thoja që nuk kam gënjyer ndonjëherë. Të them të vërtetën nuk mbaj mend ndonjë specifikë, megjithëse gënjeshtrat e fëmijërisë janë naïve, të pafajshme ose gënjeshtra të bardha, por që kam një hall të madh Jonida që nga fëmijëria e deri më sot nuk më kanë ecur gënjeshtrat për qamet, pasi skuqem dhe kuptohem menjëherë (qesh).

Sa rëndësi ka sinqeriteti për ty?

Ka rëndësinë më të madhe në

karakterin e një individi. Është virtyti që vlerësoj më së shumti tek një person, ka rëndësinë maksimale.

Më mirë një e vërtetë e hidhur apo një gënjeshtrë e bukur? Një e vërtetë e hidhur.

Cili është çelësi i një raporti perfekt sipas teje?

Ndjenja për njëri-tjetrin, sinqeriteti dhe respekti ndaj njëri-tjetrit.

Je tunduar ndonjëherë nga ideja për të bërë operacion plastik?

Jo nuk jam tunduar të paktën deri më sot.

Pushimet e kësaj vere si i kalove?

Ishte pushime të mrekullueshme, shumë energjike, shumë intensive, shumë romantike dhe shplohëse.

Çfarë të bezdis më shumë nga fakti që je e njohur?

Asgjë nuk më bezdis. Kjo është rruga që unë kam zgjedhur. Nëse do më bezdiste nuk do e kisha nisur kurrë.

Ndihesh e shpërblyer nga ana financiare si këngëtare për gjithë investimin që ke bërë dhe po bën?

Ndihem mëse e shpërblyer. Nuk ka sadsifaksion më të madh se të jesh në skenë të vlerësoshesh, të motivohesh nga duartrokitjet dhe komentet pozitive.

Je dakort që në fakt këngëtares e skandaleve paguhen më shumë?

Nuk do doja që të flisja për këtë pjesë. Nuk dua të heq paralele me askënd. Unë jam e kënaqur me ato burime që më vijnë nga muzika.

Sa e vështirë është të kesh një stil tëndin si artiste dhe mos të përflitesh për imitime apo kopje siç ndodh rëndom në muzikën shqiptare?

Nuk është e vështirë fare. Mjafton që gjërat që ti bën të vijnë natyrisht dhe ti të mos dalësh nga vetja. Unë gjithmonë jam munduar t'i përmbahem kornizës time dhe asnjëherë nuk kam marrë shembull askënd.

Çfarë të bezdis më shumë në përditshmërinë tënde?

Varfëria që shoh përreth, varfëria e ideve, varfëria shpirtërore, varfëria e humanizmit, varfëria materiale.

Të bën të lumtur fama?

Më fal kënaqësi, por nuk më bën të lumtur.



James Biberaj

Nga Hollivudi për herë të parë në film shqiptar

“Në filmin Amsterdam express” të Fatmir Koçit kam rolin e djalit të keq krahu Blerim Destanit. Të luash të keqin është shumë herë më argëtuese”

JONIDA HITOVEZI

James Biberaj është një aktor i njohur në Hollivud. Rolet e tij atje janë të shumta e krahu aktorëve të njohur në mjaft seriale e filma të preferuar edhe në Shqipëri si “Laë and Order”, “The Sopranos”, “Sex and the city” e shumë të tjerë. Këtë herë James do ta shohim në një film shqiptar, krahu aktorëve të njohur si Blerim Destani, Olta Gixhari e Flonja Kodheli. Një kastë e shkëlqyer, e cila është mbledhur nga regjisori i njohur Fatmir Koçi për filmin e tij më të ri “Amsterdam express”, i cili në qendër të tij ka një histori dashurie që zhvillohet mes Amsterdamit dhe Shqipërisë. Ne kemi mundur të zhvillojmë një bisedë me James pas përfundimit të xhirimeve të filmit, i cili na rrëfen më shumë si ishte të punojë me trupën shqiptare dhe se çfarë i ka bërë përshtypje nga qëndrimi i tij në Shqipëri.

James si je ndër në filmin e Fatmir Koçit “Amsterdam Express”?

Eksperienca këtu në fakt ishte e mrekullueshme. Unë kam lindur në Amerikë dhe kam qenë vetëm 3 vjeç kur nisa të jetoja në Nju Jork. Familja ime është nga Tropoja dhe prej disa vitesh Fatmiri ka folur me mua për të bërë këtë film. Kam parë disa nga filmat e tij dhe vërtetë më kanë pëlqyer... Ai më dërgoi skenarin, mu duk një histori shumë e mirë dhe vendosa ta bëja. Eksperienca ishte e mrekullueshme siç e thashë edhe në fillim pasi është hera e parë që bëj film në Shqipëri. Nuk e di se çfarë ju prisni singjerisht dhe si do të jetë, sepse është e lehtë kur bën filma në Amerikë dhe hidhen shumë lekë dhe është shumë më e vështirë kur nuk ke shumë para.

Si eksperiencë e parë që ishte, a ia vlejti për ty?

Po po. Ishte shumë mirë. Ekipi ishte i mrekullueshëm. Edhe nëse punon në një film në Hollivud, ekipi është i njëjtë edhe me këtë këtu. Faktikisht mbaruam sot xhirimet në mëngjes herët.....gjërat kanë shkuar shumë mirë.

Sa shpesh vjen në Shqipëri dhe çfarë mësove të re nga ky qëndrim i joti?

Kjo është hera e parë që vij në Shqipëri. Në fakt unë kam lindur në Kosovë pasi prindërit e mi lanë Tropojën. Kam lindur në Gjakovë dhe pastaj shkuam në Amerikë. Është hera e parë që vij pas 45 vjetësh.

Si tu duk Shqipëria?

Jam dashuruar me bukurinë e vendit këtu. Sidomos plazhet, deti ishin më të mrekullueshmet që kam parë ndonjëherë. Kam udhëtuar kudo në botë nga Hauai në Australi

por mund të them se natyra dhe deti janë absolutisht fantastike, mrekulli e natyrës.

Mund të ndash me lexuesin tonë pak nga eksperienca jotë në Hollivud?

Dua të them që kam qenë me shumë fat. Kam nisur të aktroj shumë vite më parë dhe mund të them se kam rreth 25 vjet që jam aktor. Ama ka qenë edhe e vështirë, sepse si të gjithë shqiptarët shkuam atje dhe e nisëm nga asgjëja. Ishte një rrugë e vështirë, por gjithmonë e kam pëlqyer punën që bëj, qysh kur kam qenë fëmijë.

Sa paguhet mesatarisht një aktor në Hollivud?

Varet. Është relative.

Po shuma më e lartë që ke marrë për një film nëse mundesh?

Kjo varet nga filmi.

Si ishte të punojë në këtë film me aktorë si Blerimi, Olta, Flonja...

Fantastike dhe aktorët ishin të mrekullueshëm, si Flonja. Jam shumë i lumtur dhe mund të krahasohet me filmat e Hollivudit. Aktrimi mbetet aktrim. Aktorët e mirë mbeten aktorë të mirë.

Cila është diferenca mes të bërit një film në kushtet shqiptare dhe një në kinematografinë amerikane?

Diferenca më e madhe është ajo e lekëve.



Jam shumë i lumtur dhe mund të krahasohet me filmat e Hollivudit. Aktrimi mbetet aktrim. Aktorët e mirë mbeten aktorë të mirë

Ata kanë më shumë lekë dhe më shumë aktorë, staf më i madh gjithë këto gjëra. Është ndryshe sa i përket parave, por arti mbetet i njëjtë.

Do kthehesh sërish në Shqipëri?

Po patjetër. Madje do sjell edhe familjen këtu, gruan dhe vajzën.

Gruaja është shqiptare?

Jo është amerikanë dhe është kërcimtare në Brodruj. Të them të drejtën s'kam pasur shans të shoh shumë nga Shqipëria për shkak të xhirimeve, ndaj dua të vij dhe të shoh e të njoh më shumë.

Çfarë të magjepsni më shumë nga ajo që pe?

E thashë plazhet, që më pare që më magjepsën. Por gjithashtu më magjepsi fakti që erdha në vendin ku të gjithë flasin shqip mbi të gjitha. Dhe singjerisht një gjë tjetër që më surprizoi ishte fakti se në çdo qytet kishe kaq shumë vende ku mund të shkoje, bare, restorante ose jeta e natës në Tiranë.

Roli juaj në film?

Unë kam një rolin e djalit të keq, kam rolin antagonist ndërsa Blerim Destani luan rolin e djalit të mirë.

U bërë xheloz që Blerimi ka rolin e djalit të mirë?

Jo. Më pëlqen. Është më shumë qejf, fun kur luan të keqin në një film.

KENGETARJA

Valbona Mema josh në pishinë, zbulon trupin me linja të kuruara



Këngëtarja e njohur e muzikës popullore Valbona Mema ka bërë një set të nxehtë fotosh, të cilën e tregojnë atë në një formë të shkëlqyer trupore. Valbona ka nambur dukshëm nga pesha e saj dhe ka rifituar linjat e hershme. Në këto foto ajo shihet mjaft seksi dhe provokuese, ndërkohë që pamjes së saj i ka shtuar edhe flokët e prerë, të cilat e tregojnë mjaft trendi.



Rezarta SHKURTA

E planifikova që vajza të jetë shenja e akrepit

"Të dy me Ermalin dëshironim që fëmija ynë të ishte vajzë"

Ajo po përjeton një nga ndjesitë më të bukura në botë për një femër. Së shpejti do të bëhet nënë dhe këtë gëzim Rezarta e ka ndarë në një rrëfim të gjatë për revistën "Psikologji". Ka preferuar të mos flasë shumë në media për këtë moment të jetës së saj, siç zakonisht ndodh me femrat e njohura të botës së spektaklit, artit apo qoftë edhe politikës. Një ndjesi të ëmbël të cilën ajo po e shijon me familjen e saj, ku kujdesi i Ermalit është maksimal. Në rrëfimin që Rezi ka bërë ajo ka zbuluar disa të fshehta, nëse do të mund t'i quajmë kështu rreth vajzës së saj që do të lind pikërisht në muajin që vetë Rezarta ka zgjedhur. "Jam e dhënë pas astrologjisë dhe ndër gjërat që më pëlqen të informohem gjithmonë është horoskopi. Personalisht jam Akrep. Edhe pse një shenjë

rebele e impulsive hera-herës, Akrepi është shenjë magjike. Ka pikë të fortë korrektesinë, punën dhe artin. Këtu u tregova pak egoiste, pasi planifikuam gjithçka që dhe bebushja jonë t'i përkasë shenjës së Akrepit. Dhe kjo ishte një ndër dëshirat e tjera që natyra deshi të na e plotësonte, e bebushja jonë që do lind në fund-tetori. Do t'i përkasë shenjës së Akrepit, duke uruar nga zemra që gjithçka të shkojë mirë deri në fund", është shprehur ajo në intervistën e saj dhënë për revistën. Veç kësaj Rezarta ka pohuar se si ajo dhe Ermali dëshironin të bëheshin prindërit e një vajze dhe kjo dëshirë tashmë po përmbushet. Gjithashtu ajo ka pohuar se do që vajza t'i ngajj Ermalit. "E adhuroj Ermalin

pafund. Është princi im. Më i bukur i kësaj bote, e do ishte dëshira ime më e madhe të ngjante atij. Nga unë do doja vetëm talentin dhe dashurinë për artin", ka thënë artistja, teksa më tej ka thënë se nuk dëshiron që fëmija i saj të jetë publikë. "Unë dhe Ermali kemi vendosur që nuk do ta bëjmë publike identitetin e vajzës sonë. Duam ta kemi vetëm për vete, e familjet tona. Përveç kësaj, duam që mos të imponojmë asgjë, por që të jetë ajo që të vendosë kur të rritet, për profilin e saj". Ky ka qenë një nga rrëfimet e para të gjata të Rezit për mëmësinë, duke u shfaqur në koper-tinë me foto sensuale që shkojnë për shtat me gjithë larminë e ndjesive magjike që ajo po përjeton.



TOROSI BB4 Takon aktorin e famshëm Nicolas Cage

Këto ditë në Venecia është duke u zhvilluar festivali i Filmit, një paradë e vërtetë yjesh e personazhesh të famshëm e të adhuruar nga gjithë bota. Gjithashtu një event ku jo të gjithë e kanë fatin ta shijojnë nga afër. Megjithatë në mund të krenohemi sepse në këtë festival ndod-

het edhe një djalë shqiptar, banori i BB4 Toros, i cili ka postuar vazhdimisht foto në Facebook nga parada e yjeve siç ishte Sandra Bullock apo Xhorxh Kluni. Duke përfutur nga rasti, Toros ka takuar aktorin e famshëm Nicolas Cage me të cilin ka bërë edhe fotot e mëposhtme.



DEVIS XHERAHU Për gjueti për derra të egër me shapka

Këngëtarë Devis Xherahu duket se është i kapacionuar pas natyrës e sidomos pas gjuetisë. Në profilin e tij në Facebook ai ka postuar disa foto ku shihet së bashku me të dashurën e tij, ish misin Ertemiona Mejdan. Çifti ka ndarë me fansat fillimin e fundjavës ku me një makinë sportive dhe me çiftë në dorë janë nisur për gjah. Vet Devi ka thënë se i pëlqen të gjuajë derra të egër dhe ne urojmë që të mund t'i gjej ata. Veç kësaj ajo që na ka tërhequr vëmendjen në foto është se Devisi ka zgjedhur të shkojë për gjueti me shapka. Urojmë t'ia dalë të eci në terrenin e vështirë që e pret, pasi gjuetia nuk është si të shkosh në plazh!

MISI ADROLA DUSHI Shtatzënë në muajin e 7-të

Ajo është vetëm 20 vjeçe dhe mban ende kurorën e Miss Universe, të cilën e mori në vitin 2012. Bukuroshja nga Rrësheni, e cila përfaqësoi Shqipërinë në "Miss Univers", por që nuk arriti dot të klasifikohet në 15 më të mirat, tanimë po provon një tjetër ndjesi në jetën e saj. Ajo

po pret të bëhet nënë për herë të parë edhe pse në një moshë të vogël. Ndjesinë e bukur që po përjeton ajo e ka mishëruar në këtë foto, ku njeriu i jetës së saj po i puth barkun. Adrola gjithmonë në çdo intervistë ka thënë se është e dashuruar, por që të bëjë nënë kaq shpejt nuk e prisnim!



Klajda Gjoshja I jep fund beqarisë, sekretet e martesës me 350 të ftuar

Ministria e Integritetit: Nuk dua të më preket intimiteti i ceremonisë

JONIDA HITOVEZI

Herën e fundit që e pamë ishte krah Ramës në përgatitjen e qeverisë së re, në të cilën ajo do të jetë Ministria e Integritetit. Një moment i mirë në karrierën e saj, i cili duket se ka përkuar në mënyrë perfekte me një tjetër gëzim në jetën personale të Klajda Gjoshës, e cila sot vendosë t'i jap fund beqarisë dhe të martohet me njeriun, me të cilin ka plot 15 vjet që është e dashuruar. Gjithçka është gati për ceremoninë madhështore, e cila nga burime konfidenciale kemi mësuar se do të bëhet në Pezë, pikërisht në atë që nga banorët njihet si vila e Dash Pezës e që tani është bërë lokal. Ndërkohë për gjithë kolegët e LSI-së Klajda ka rezervuar një koktail tek Rogner ditën e enjte, në të cilin nuk kanë munguar kolegët e ftuar, por ka munguar Iliri dhe Monika, të cilët nuk kanë mundur të jenë të pranishëm për shkak se kanë qenë jashtë shtetit. Gjithçka ka kaluar perfekt gjatë mbremjes të së enjtes, ku miq e kolegë i kanë uruar ministres së re, jetë të lumtur me njeriun e zemrës.

DETAJET E DASMËS

Është një nga ditët më të veçanta për çdo femër, dita e kurorëzimit të dashurisë me martesë dhe po aq e veçantë mbetet secila nga ceremonitë që çifti organizon për një ditë speciale si ajo e fundit të beqarisë. Nga sa kemi mundur të mësojmë Ministria e Integritetit për këtë ditë të veçantë ka preferuar diçka shumë romantike. Dekorimi tërësisht i veçantë, mensional me lule, të duket sikur dalin nga Një efekt special bëhet për herë të parë në Shqipëri nga "Geraldina Sposa" dhe që plotëson kuadrin e atmosferës magjike në tavoli-

350 të ftuar do të jenë të pranishëm në dasmën e Klajdës dhe Adrianit dhe ceremonia do të jetë e përbashkët

NË FOTO: Klajda Gjoshja dhe Edi Rama në mbledhjen e qeverisë së re në Vlorë



nat e dekoruara me mjaft kujdes. Gjithçka është kurrar imtësisht për të dhënë efektin e duhur, ku kryefjala është "romanticitet". 350 të ftuar do të jenë të pranishëm në dasmën e Klajdës dhe Adrianit dhe ceremonia do të jetë e përbashkët, një zgjedhje që duket se dominon së fundmi tek çiftet e reja shqiptare që vendosin të martohen. Nusja për ditën e dasmës së saj ka zgjedhur 3 fustane, të cilët kemi mësuar se janë nga firma shumë të njohura.

I pari që është i shkurtër është "Pronovias", tjetri i firmës së njohur "Motta" dhe i treti është nga koleksionet trend të këtij viti, nga fustanet me lule. Gjithashtu

kemi mësuar se këta fustane janë të personalizuar dhe nuk mund t'i gesh aq kollaj në katalogët e këtij viti. Për të mësuar më shumë rreth përjetimeve të Klajdës, jemi përpjekur të mësojmë diçka nga goja e saj, por ajo është shprehur se nuk dëshiron t'i cënohet intimiteti i ceremonisë, të paktën deri sa dasma të mbarojë.

HISTORIA E DASHURISË ME ADRIANIN QYSH NË GJIMNAZ

Klajda Gjoshja dhe i fejuari i saj Adriani, për të cilin kemi mësuar

Ata janë njohur bashkë qysh kur Klajda ka qenë 15 vjeçe dhe të dy kanë mbaruar bashkë gjimnazin



se ka një agjensi turistike kanë një histori të bukur dashurie. Ata janë njohur bashkë qysh kur Klajda ka qenë 15 vjeçe dhe të dy kanë mbaruar bashkë gjimnazin. Më pas Klajda është larguar nga Shqipëria drejt Anglisë për studime. Siç ka pohuar ajo në emisionin "Dita ime" në Vizion plus lidhja në distancë ka qenë e vështirë, pasi në vitin 2000 nuk kishte lehtësira si interneti apo rrjetet sociale.

"Ka qenë e vështirë lidhja në distancë pasi komunikimim një herë në javë. Por jam krenare që kjo marrëdhënie i ka rezistuar kohës", ka thënë ajo. Historia e dashurisë 15 vjeçare merr start në Shkollën e Mesme "Ismaël Qemali" ku çifti që sot martohet qëllon të ishin shokë të një klase. Më pas nga miqësia shumë e fortë që ata kishin për njëri-tjetrin lindi dhe historia e dashurisë, e cila sot kurorëzohet jo vetëm si e tillë, por edhe si një provë që ndjenjat e vërteta i mbijetojnë jo vetëm kohës por edhe largësisë.

Ndërkohë në një nga intervistat që ka dhënë së fundmi në media rreth të fejuarit të saj, Klajda është shprehur se Adriani është tepër i qetë, me shumë vullnet dhe mbi të gjitha shumë tolerant.

"Në këto momente të karrierës sime është mbështetja më e madhe që unë kam", ka thënë ajo teksa ka folur edhe për dasmën, për të cilën ka thënë se dëshiron një ceremoni të madhe, me të gjithë njerëzit më të dashur për të dhe Adrianin. Diçka moderne, por pa humbur traditën dhe kjo dëshirë e saj tashmë është realizuar.

Nuk na mbetet tjetër veçse në fund të këtyre rreshtave ta urojmë Klajdën në këtë ditë të veçantë të jetës së saj; qoftë e lumtur me njeriun e zemrës së saj!

Publicistikë

TIRANE
ADMIRINA PEÇI

Zbulohen dy shkrime të panjohura të Fishtës

Kolec Çefa: Janë botuar pa emër, por janë identifikuar. Një shkrim mbi problemet e gjuhës, dhe një tjetër mbi sulmet e qeverisë së Iljaz Vrijonit ndaj Markagjonajve

Një grup shkrimesh të panjohura të At Gjergj Fishtës janë bërë objekt kërkimi për studiuesin Kolec Çefa, një njohës i mirë i veprës së Fishtës dhe kontribues i madh i mbledhjes dhe identifikimit të saj. Ai pohon se ka vënë re, që në shumë botime ku është përmblodhur krijimtaria letrare dhe studimore e Fishtës vihet re mungesa e disa artikujve të botuar në shtypin e kohës, të cilave ju mungon autorësia, por që studiuesi i ka verifikuar përfundimisht se ato i përkasin At Fishtës.

“Në gazetën “Posta e Shqipnis” janë botue disa artikuj si: “Përmbi burim të gjuhvet letrare” dhe artikulli “Mikrobët e gjuhës shqype”, të cilët, tue qenë pa firmë, janë lanë jashtë përmblodhjeve”, shënon në një studim të tij Kolec Çefa. Ai thekson se në fakt është edhe Prof. Kostallari i cili e përmend këtë fakt. Ai shkruan: “Artikulli nuk nënshkruhet, por, sipas shumë shenjave, duket se mund të jetë shkruar nga Gjergj Fishta, drejtues i këtij organi”. Po ashtu Çefa pohon se edhe Prof. Dr. Nuri Gokaj i njeher për të Fishtës.

“Subjekti gjuhësor aq shpesh i rrahun prej Fishtës, madje i rrahun me kulturë të gjatë e pasion atdhetari për tanë jetën, ka qenë i parapelqyem që në fillimet e krijimtarisë së tij. Edhe punoi e shkroi shumë për alfabetin tonë, gjuhën shqipe e shkollën kombtare”, vëren studiuesi Çefa.

Siç shkruante Fishta “gjuha letrare është e ujdisme me shije estetike e e xjerrme prej gurret të vet të gjallë, që është goja e popullit, prej visarit të kombit që është literatura e përbame me mund e me kohë;... se për përparim të gjuhës amtare është nevoja me u libruce ç’prej themelit politikisht”; ... se gjuhën e ndërtojnë shkrimtarët e dijetarët e zanatit”.

Nisur nga kjo studiuesi Çefa, shkruan se Fishta nuk pranonte dekrete as porosi nga nalt për gjuhën shqipe, nuk ishte për ngutje, nuk ishte për shtatime dialektesh.

“Këto mendime e trajtimin i këtij subjekti, me stilin e tij fishtian; fjalori i tij i pasun e frazeologjia karakteristike në pendën e Fishtës, më çuen tek përfundimi se proza e pamblodhur “Mikrobët e gjuhës shqype”, si edhe “Përmbi burim të gjuhvet letrare”, sado pa firmë autori, (ka edhe shkrime tjera në “Postë...” të Fishtës pa firmë autori të pamblodhura) kanë dalë nga mendja e penda e Fishtës, prandaj duhet të rreshtohet si krijim letrar i Fishtës.

Më tej studiuesi Kolec Çefa përmend se po në gazetën “Posta e Shqipnis” Fishta ka botuar një regjion për veprën e Mjedës “Juvenilia”, si edhe një recensionin të dytë për “Juvenilian” me titull “Literaturë shqype”, si edhe një analizë kritike për Kolliqin. Por mjaft ngacmues është edhe një shkrim, po ashtu i pafirmosur por që është vërtetuar se i takon Gjergj Fishtës, i botuar në vitin 1921 në gazetën “Shkumbini” me titullin “Fjalë të reja e mentalitete të vjetra”.

Këtë artikull sikurse edhe “Mikrobët e gjuhës shqype” po i sjellim më poshtë për lexuesin.

“MIKROBËT E GJUHËS” shqipe u botua në “Posta e Shqipnis”, më 1918, pa emër, por u identifikua si i Fishtës. Po ashtu edhe shkrimi “Fjalë të reja e mentalitete të vjetra” botuar në gazetën “Shkumbini” më 1921...



◀ NË FOTO: Në vitin 1941, në kuadrin e përgatitjeve për boshitimet speciale kushtuar Atë Gjergj Fishtës, fotografi Shan Pici, ka bërë edhe riprodhimin e një fotografie të vjetër ku poeti kishte dalë, vite më parë kur kthehej herë pas here. Kuvendin e T rroshanit. Kjo foto tërhoqi vemendjen e fotografit të ri, sepse aty poeti kishte dalë së bashku me fshatarët e tij të katundit Fishtë

Artikulli i parë

Fjalë të reja e mentalitete të vjetra

Sot është tuj u vra shqiptari me shqiptarë. Sot një krahinë e përmendun e Shqipnisë, Mirditës, është tuj u la në gjak të shqyptarëve! Punë fort e ligë; punë e keqe fort! Kush e ka fajin?

Qatje kah nbarimi i qershorit të këtij vjeti doli fjala e mori dhën, se paria e Mirditës, Z. Marka Gjoni i Gjomarkajve, po e kishte ba pleqni me krën të vendit, m’e shkëpë Mirditën prej Qeverijet të Tiranës e me ngrët per te një qeveri tjetër të re, e se, per me i dalë kësaj pune në krye, po kishte kalue deri në Prizren, per me lypë prej serbëve ndihmë financiare e ndihmë morale a diplomatike.

Qeveria jonë e paska pasë ndie ket fjalë e menjherë vendueka, me çue në Mirditë një forcë ushtarake, per me prue me fuqi t’ armëve Marka Gjoni në fille, me gjith krën e me gjith popull kreshnik t’atij vendi.

Të ndershmët deputetët e Shkodres, tuj marrë vesh se ishte kah mëkambej një ushtri me i ra Mirditës, i tërhoqën vërejtjen qeverisë, se mëndorja e kohëve e e vendit e lypete, që bashkë me ushtri të dërgohet edhe një komi-

sion, për me u marrë vesh një herë ma para me Kapitan Marka Gjoni e me tjerë krën të Mirditës mbi shkaqë të verteta, që i kishin shtye me lypë të ndamit e Mirdites prej qeverijet të Tiranës. Mbas projektit të të ndershemve deputetë

të Shkodrës, komisioni do të përbahej prej katër vetëve: tre zotni shkodranë, dy katolikë e një muhamedan, e Bajram Beg Curri, i cili do të ishte kryetar i komisionit e komandar i ushtrisë, kështu që mos të dilte kurri kundërshtim i damshëm ndërmjet komisionit e komandet ushtarake. Proponuem Bajram Beg Curri,

pse ky vetë e shpija e tij, jo veç mbas luftave e kryengritjeve, që në këto vjetë e mbrame kanë shëmtue vendin tonë, por edhe perpara, ishte në lidhni miqasore me derë të Gjomarkajve e me popull mbarë të Mirditës e, pse edhe vjet që shkoi u

ditue burrë e komandar i zoti në të shtypun t’ esadistëve. Ma teper do dijtë, se i gjith popull katolik i Shqipnisë së Eper ka një besim të plotë në burri e në bujari të këtij burri të ndershëm.

Qeverija një herë e parapa plotësisht projektin e deputetëve të Shkodrës, por mbasandaj, per arsye që parlamenti do ta kishte me de-tyrë me e dijtë, e qiti poshtë. Lëshoi esadistat prej burgut, siguroi milionat në kasë të financës, edhe, nën komandë të Z. Kolonelit Ali Fehmi Beg Kosturit, ia lëshoi ushtrinë në shpinë Mirditës. E kështu, shi në këto kohë historike zunë

me u vra e me u pre shqyptarët ndermjet vetit.

Edhe na jemi mendimit, që në Shqipni mos të ketë veçse një qeveri të vetme, pse kështu njijina e jeta e kombit sigurohet ma mirë. Por kur të marrim para

sysh, se edhe njeti aty-këtu nëpër botë ka shtete të mbarështueme nder kantone, me një qeveri qandrorë, si Austro-Hungaria motit e Helvecia në ditë të sodit, na, per me u dashtë me u dhanë fjalëvev kuptimin e vet të vertetë, ma fort se një tratti, çastjen e sotme të Mirditës e mbajmë një çastje politike të përmbrëshme: pse edhe qeverija nuk mundet me na vertetue pozitivisht, se me ket lëvizje Kapiten Marka Gjoni do pernjimend me i lëshue shteg jugosllavit, që të dalë në skele të Shnjinit. Por edhe me pasë per të kenë e vertetë kjo fjalë, nuk kishte me kenë arsye me u çue na e me mbyttë shoqi-shoqin, tue kenë se të lëshuemit a të moslëshuemit shteg jugosllavëve neper Mirditë, nuk është një çastje kjo që mund të rregullohet prej Kapiten Marka Gjoni a Eljaz Beg Vrijonit, por prej Konferencës së Paqes.

Prandaj na nuk kuptojmë se si mund të jetë, që shi njaço qeveri e cila jep autonominë administrative Himares, ku ende nuk është e sigurtë, se populli i atij vendi, pa u hap një plebshitet prej anës së Konferencës së Paqes, dishmohet


Qeverija një herë e parapa plotësisht projektin e deputetëve të Shkodrës, por mbasandaj, per arsye që parlamenti do ta kishte me de-tyrë me e dijtë, e qiti poshtë



ARTIKULLI I DYTË

Mikrobët e gjuhës shqype

■■■ TIRANE



Gjergj Fishta

shqiptar: që shi njajo qeveri, e cila lëshon prej burgut njata shqiptarë, që vjet me ndihmën e serbëvet dojshin me ba që jo veç Mirdita të shkepej prej qeverijet të Tiranës, por që me gjith Shkoder t'i lëshohet Jugosllavisë, nuk kuptojmë, po thomi na, se si njajo qeveri të shkjojë sod e të vrasë e të therë Mirditast që lypin vetëm me u shkepë prej qeverijet të Tiranës, mbasi edhe Turqija, ligji i së cilës sod me sod zotnon në Shqypni, ia ka pasë njoftë një administratë privilegjante.

Por këto janë punë që i perkasin kompetencës së parlamentit, na këtu vetem duem të pyesim qeverinë: çka bani ajo e ç'mjete të paqta perdoror per të bamë që Mirdita mos të lypete me u shkepë prej qeverijet qandrorë? Duhet dijtë, se nder shtete parlamentare nuk janë vetem mitralozat e topat, që mbajnë qetësinë nder krahina të ndryshme të atdheut, mandej ka pasë thanë edhe ai i moçmi: nandëdhetanandë urti e nji trimmi.

Se asht zanë fill Shqypnia zyrtare e e ligjshme, duem me thanë, prej 1914 e deri sot, shtetin tonë e kanë sundue këto qeveri:

1. Qeverija e Princ Vedit.
 2. Qeverija e Turkhan Pashës
 3. Qeverija e Sulejman Beg Delvinës
 4. Dy qeveritë e Eljaz Beg Vrijonit.
- Tash të gjitha këto qeveri çka banë për Mirditë, ose ma mirë, të

thomi, për Shqypninë Veriore? Njihërë qeverija e Princit Vied me i lajmue s'i lajmoi popullit mbi Breg të Matës e perpjete, se Shqypnija kishte dalë shtet më vedit e se kishte edhe nji princ suveren të vetin: pse, sa per dhetë miljonat ar që aso kohe u shpenzuan në gjashtë muaj, as nji dy pare si nuk u dha per të mirë të kësaj krahine. Per qeverinë e Turkhan Pashë dihet vetem këta, që dërgoi njihërë në Lezhë për çashjtje të dhetave të Zadrimës e se desh të ngrefë nji nenprefekturë në Bushat. Nen qeverinë e Sulejman

Beg Delvinës u ngref lufta me jugosllavë në Hot e në Kastrat, nuk dihet se pse, edhe u rrenue Malcija e Madhe, nji krah i fortë i Shqypnisë. Ma teper kjo qeveri organizoi nji operacion ushtarak në Zadrimë e t'i lëshoi mbi shpinë atij populli Shkoder e Postrripë, ushtarë e bashibuzukë, e gjendarë gjithfarë ngjyret e veshet, me bajrakë e me burija e

me teneqe, të cillët, mandej, kjenë gatë tue u vra shoq me shoq, pse ky po hante pata ma shum, jo pse ai po rruente biba e desh e që të Zadrimës, si t'ishite kjo armik e jo pjesë plotësuese e Shqypnisë. E po qeverija e Eljaz Vrijonit? Si të gjitha tjerat. As ndreqi rrugë, as shtroi urë, as çili treg, as vu rend e rregull e nder 503 shkolla, që mban shteti shqypnar në të gjith prefekturën e Shkodrës ngrefi vetem tetëmbëdh-

Per njimend se asht nji punë per t'u çuditë, që nji grusht njerëz në gji t'Europës, që jemi na shqypnarët, tue kenë ndoshta kombi ma i vjetri i të gjithë Europës e rrethue per gjith anesh prej kombeve të tjera ka mujtë me ruejtë deri sod gjuhën e vet m'vedi e krejt të dame prej gjuhëve tjera europjane. E pra, kush nuk u pershkue neper ne! Mjaft me thanë romakët e turqit, dy pushtete të perfrigueshme: e me gjith kta, shqypja gjallë se gjallë, e, shka asht ma teper, perditë tue u zhdrivillue ma fort. Asht lypë forca e konservatorizmi i nji kombi shqypnar, per me e ruejtë gjuhën e vet të gjallë e të kerthnezitë ndermjet zhuhurit të gjuhëve të slavëve, të grekve e nen imperjalizem të kulturës

latine, pse dihet që ka kombe n'Europë, të cillat sod nuk flasin ma gjuhën originale të veten, por gjuhë të hueja. Por tue vu në oroe korespondencën e perditshme, që na vjen prej Shqypnijet, shkrimet që cohen me u botue në shtypshkrojtë tonë, munden ma thanë, se çka nuk mërrijten me ba në gjuhë shqype grekët, romakët, gotët, slavët etj. janë tue e ba sod shqypnarët vetë: janë tue e hupë gjuhën shqype! Nen shkak që gjuha shqype s'ka literaturë të veten, kanë nisë të shkruajnë shqyp secilli mbas atij qirificit të mendes së vet, pa e vù në oroe aspak natyrën e gjuhës, a shijen estetike e arsyetimin e ligjeratës njerëzore. Kanë këndue ndonji fletore të hershme, ase, neper të, edhe ndonji liber shqyp, botue prej ndoj geget a tokset si neper kllapi a me pasë kenë tue qitë laknuer me nëne e qe se ato 10-15 kokrra fjalë ekzotike, që u kanë mbetë nder trù të shtypuna a librat shqyp, kanë per t'u mundue me e folë, kanë per t'i mbjellë aty-ktu neper shkrime të veta si me lëshue guraleca në brum të bukës kallamaqe, në short me të theye dhambët e tmallët e shëndosha. Tjerët kahë nuk i ka lanë shpija mbrendë, kanë kerkuë dhenë si parja e kuqe, e kur kanë shtegtuë neper Shqypni, të ngushtuem me u marrë veshit a gega me toskë, a toska me gegë, kanë shkue tue shartue njanin djaletk me fjetrin, pa kurrfarë mjeshtrijet porsì me shartue shegat me fiq e të kanë perba nji gjuhë krejt në vedit, që s'di a asht kâl, a mushk, a gomar e që ma fort se gjuhë shqype, kishte me u dashë me e quejtë sallahane. E, ka asish masandej, e janë sidomos do nëpunës na Shqypni e nxeanësat tonë jashta Shqypnije, të cillët, ma fort se me studiuë natyrën e gjuhës a librat shqyp kanë per t'u mundue me folë e me e shkruë shqypen mbas mënydrës që ta flasë drejtori i zyres, per në kjojtë nëpunës e, per në kjojtë nxeanës ka per t'i marrë



Asht lypë forca e konservatorizmi i nji kombi shqypnar, per me e ruejtë gjuhën e vet të gjallë e të kerthnezitë ndermjet zhuhurit të gjuhëve të slavëve, të grekve e nen imperjalizem të kulturës latine

ngjatët puna kso doret, s'ka me shkue shum e na kemi me kenë të ngushtuem me folë e me shkruë në gjuhë të huejen, pse gjuha shqype ka me dekë, pa dyshim, mbassi i kanë hi sod mikrobët që janë shkrimtarët e padije e të pa zeje. Thonë se gjuha shqype s'ka literaturë e gjuhë letrare të veten. Asht trenë! Gjuha shqype ka literaturë, veçse s'ka lertrarë, sa kishte me u dashë. Padija në literaturë e një shumicës së madhe të shqypnarëve të sodshëm, ka ba që perparimi i literaturës së gjuhës shqype sod ka kthye, pak me thanë, 50 vjet mbrapa. Prej zekthit të marrë që me u dukë lertrarë pa kenë, sod asht pshtjellue gjuha shqype në mënyrë që mos me mujtë me këndue dy rreshta shqyp, perpa t'u çue vneri. Urojme që shqypnarët e meçëm e sidomos Komisjoni Letrar kanë me u mundue me i shtypë me shkrime të veta kta mikrobë parazita të gjuhës shqype.

(“Posta e Shqypnisë”, 1918, nr.30, F.4).

hetë shkolla fillore e dy qytetëse. Një punë tek asht: të kallëzoj vetë ç'të mirë i suell qeverija e tij Shqypnisë së Eper, që me therqë prej vedit besimin e saj? Këtu, posë mungesash të kësaj qeverije, kishim me mujtë të njehim edhe shum e shum gabime e shperdorime autoriteti të bame prej anës së kësaj qeverije, por ngushtica e fletores

na pengon të zgjanohemi ma teper nder këto fjalë. Tash nji qeveri që s'asht e zoja t'i sjell nji të mirë vendit dhe asht e ngushtuem të ngrefë luftë dy-tri herë në vjetë me popull të vet, dmth, se gjindja e saj ende s'e kanë mentalitetin e perbamë, per me vu nevojët e kohëve të sodshme e të sistemeve të reja. Edhe Turqit e Ri dhanë konstitucionin e

mbasandej çuen Turgut Pashat e Xhavit Pashat me topa e mitralozna nëper Shqypni.

Por mos të harrojtë qeverija, se ka thanë i moçmi, që: “kush mbjellë erë, korë duhi”.

(Kjo prozë, e panjohun si e Fishtës, u botue në gazetën “Shkumbini”, nr. 30, datë 16.9.1921.)



VËLLANË TIM E DHUNON BASHKËSHORTJA

E dashur Mirela,
E di qe kjo rubrikë është për dhunën ndaj grave, por besoj jeni në dijeni se dhuna ushtrohet edhe ndaj burrave. Unë po ju shkruaj pasi jam e shqetësuar për vëllanë tim, i cili që kur është martuar është transformuar si njeri. E kemi vëllë të vetëm dhe më i vogli pas tri motrash. Imagjinoni çfarë gëzimi kanë përjetuar prindërit e mi me të. Por martesë e ka ndryshuar totalisht. Tani ai është kthyer në bebisiter dhe puna e tij është të kujdeset për vajzën që sapo ka lindur. Aika përjetuar për një kohë të gjatë stres pasi nuk arriti të gjente një punë, dhe tani e shoqja punon ndërsa ai është kthyer në shtëpiak që t'i shërbejë asaj.

Në fakt disa herë unë dhe motrat e mia jemi përpjekur që t'i qejmë një punë, por ajo nuk e ka lejuar që të mbajë kontakte të rregullta me ne, e ka larguar totalisht prej nesh. E di që emancipimi i femrës ka marrë hov vitet e fundit edhe në Shqipëri, por deri aty sa gruaja të dalë në punë dhe burri të rrijë në shtëpi që të kujdeset për fëmijën s'ma kishte marrë mendja. Nuk arritja ta kuptoj se çfarë ka ndodhur me vëllanë tim. Menjëherë pas martesës u largua nga shtëpia e prindërve të mi edhe pse kishin një

shtëpi të madhe. E shoqja ushtron një presion të jashtëzakonshëm ndaj tij dhe jam e sigurt se kjo është dhunë. Unë nuk mund të them se e dhunon fizikisht pasi nuk e di se çfarë ndodh mes tyre në shtëpi, por e di që dhuna ka edhe forma të tjera.

Para disa muajsh ne ishim në një dasëm dhe në një qoshe vjedhurazi e kam dëgjuar kumatën time duke u çjerrë vëllait tim me të madhe, i ulëritur sa kishte fuqi dhe ai nuk i kthente përgjigje. Nuk di çfarë të bëj, jam ulur poshtë një peme dhe kam qarë me ngashërim. E shikoj vëllanë tim në atë gjendje dhe nuk e ndihmoja dot. Jam përpjekur disa herë të bisedoj me të dhe t'i lë të kuptoj se nëse ka nevojë për ndihmë unë jam aty për të, por ai nuk tregon asgjë. Madje thotë se është i lumtur me gruan që ka. Kur tentova një ditë të flas për të ai ma tha prerë, "Nuk të lejoj të flasësh për të. E di vetë se çfarë bëj me jetën time". Si mund ta ndihmojë nëse ai është nuk është i vetëdijshme për gjendjen e tij.

Më vjen keq për nënën sepse ajo e vuan më shumë se askush. Edhe pse është e moshuar e kapton se në çfarë situatë ndodhet i biri. Nuset e sotme janë modernizuar aq shumë sa u bëjnë luginj burrave. Vishen e lyhen në mënyrë ekstravagante, pinë duhan, i japin makinës, bëjnë karrierë dhe jam dakord deri këtu, por në rastin e vëllait tim është abuzim. Ai lan, gatuan, pastron, kujdeset për fëmijën ndërsa ajo pi kafe me shoqet. Të lutem a mund të më thuash, a është kjo dhunë?

Mund ta marrësh më vonë se është i zënë tani". Po sigurisht që mund të jetë i zënë, duke larë pjatat, duke ndërruar pampersat apo duke gatuar.

Jam shumë e shqetësuar për tim vëllë sepse tani që është pa punë ndihet i rënë moralisht ndaj ndoshta kjo është arsyeja që i duhet të durojë presionin e saj. Ajo sjell lekët në shtëpi dhe ai duhet të durojë pasi nuk ka rrugë tjetër.

Nuk di si ta ndihmoj kur ai nuk e pranon ndihmën time, çfarë mund të bëj për të kur ai një ditë ma tha troç, "Nuk kam nevojë për ndihmë, kam nevojë të më lini të bëj jetën time". Pas kësaj bisede unë jam e pafuqishme ta ndihmoj, por kur shoh gra që përfitojnë nga raste të tilla ndihem shumë keq.

Unë e vlerësoj rubrikën që ju keni hapur te shqiptarja.com pasi është shumë e vlefshme për gratë ndaj të cilave ushtrohet dhunë, por nga ana tjetër jam e shqetësuar sepse ka edhe gra që e keqpërdorin lirinë që u jepet. E ndoshta duke u dhënë kaq shumë liri nuk është mirë. Unë jam vetë grua por ama ashtu siç di të drejtat e mia di të respektoj edhe të drejtat e burrit. Ne jemi rritur e edukuar në një vend që për vite me radhë na ka ushqyer një frymë të tillë që burri ka disa prioritetet dhe ndoshta na duhet kohë deri sa të gjejmë një balancë. Me këtë nuk dua të them se është mirë që ne tua japim me dëshirë të drejtën burrave për të na drejtuar por barazia nuk mund të vijë në mënyrë drastike. Ashtu siç po përballimi me tranzicione të tjera në këtë shoqëri dhe barazia gjinore është një proces që kërkon kohë.

Më fabni se ndoshta u zgjata por do të isha e interesuar të dija përgjigjen tuaj. Me respekt. F.

...ai lan, gatuan, pastron, kujdeset për fëmijën ndërsa ajo pi kafe me shoqet. Të lutem a mund të më thuash, a është kjo dhunë?

Analiza

Nuk e ndihmot dot, atë që nuk do



NGA MIRELA SULA

fëmijët. Ende edhe sot, ky realitet mbetet një mit i pashyer tek ne.

Sigurisht që dhuna ka forma të ndryshme, përfshirë atë psikologjike, fizike, seksuale, financiare dhe emocionale: dhe burrat nuk përjashtohen nga ky realitet. Me kaq sa tregohet në këtë letër unë nuk mund të them me siguri se vëllai juaj është në të tillë preston. Sa kohë ai nuk e pranon këtë fakt, e bën edhe më të vështirë për ta kuptuar situatën të cilën ti e përshkruan nga këndvështrimi yt. Dëshira jote për ta ndihmuar nuk përpulhet me gatishmërinë e tij për ta pranuar këtë ndihmë. Për më tepër ai nuk mendon se ka nevojë për ndihmë, dhe këtë e thotë qartë në përgjigjen që të ka dhënë. Në këtë rast është e vështirë të presësh se gjërat mund të ndryshojnë.

Më vjen ndërmend një tregim të cilin e përdorim shpesh në psikoterapi pozitive: Një burrë po mbytej në një moçal dhe po thërriste "Ndihmë, ndihmë"! Shumë veta që po kalonin aty rrotull u afruan duke i zgatur duart, por e pamundur për ta nxjerrë. Një cast afrohet një plak i mençur dhe pyet "Çfarë po bëni o njerëz? - Ja, po mudoheja ta shpëtojmë, se po mbytet. - Po ju a nuk e shikoni se ai ka nuk e ka zgatur dorën - ua kthen plakun. Nëse ai nuk zgjat dorën që të kapet pas jush ai nuk mund të dalë nga moçali".

Besoj se morali i fabulës është shumë i qartë. Ne



shpesh duam të ndihmojmë njerëzit tanë të dashur, por ata nuk zgjasin dorën që ta pranojnë ndihmën tonë. Madje në rastin e vëllait tënd situata duket edhe më e komplikuar pasi ai jo vetëm që nuk zgjat dorën, por as nuk thërrret për ndihmë. Përkundrazi thirrja e tij është që ju "ta lini që të bëjë jetën e vet". Shpesh edhe kur klientët vijnë në terapi, as psikologu nuk arrin t'i ndihmojë dot, nëse ata nuk zgjasin dorën dhe të bashkëpunojnë, që të dalin nga situata në të cilën ndodhin. Ndoshta ti mendon se vëllai yt është në moçal, por cila do të ishte përgjigja e tij nëse e pyesim atë? Nga përvoja ime me terapi dhe e familjes kam mësuar se njerëzit e të njëjtës familje e tregojnë të njëjtën histori

në mënyra krejt të ndryshme, a thua se nuk po flasin për të njëjtën gjë. Prandaj, për të, ka gjasa që të mos jetë moçal, por fushë në të cilën ai dëshiron të qëndrojë aty. Sa kohë ai nuk ndjen të nevojshme të ndry-

shojë, as ti, dhe askush tjetër nuk mund ta ndihmojë.

E dashur F, e di që ti kërkon me shpirt ta ndihmosh vëllanë tënd, por nëse ai nuk dëshiron të dalë nga "moçali" nuk mund të bësh asgjë. Unë

nuk e përjashtoj mundësinë që vëllai juaj të jetë i varur nga e shoqja financiarisht, emocionalisht apo nga forma të tjera të lidhjes me të. Edhe nëse në ndonjë rast kjo varësi merr trajta të abuzimit apo të dhunës, ju nuk mund të bëni asgjë nëse ai nuk ndërjegjësohet për këtë. Në raste të tilla, qoftë burrë apo grua, reagimet shpesh janë të njëjta: zgjedhje me vullnetin e lirë për të qëndruar në marrëdhënien e tyre, qoftë ajo edhe abuzuese. Njerëzve shpesh u duhet kohë e gjatë për të kuptuar se çfarë nuk dinë, dhe "nuk janë në dijeni për mungesën e dijës" apo aftësisë për të ndryshuar rrethanat në jetën e tyre.

Për ta mbyllur do të doja të theksoja se fakti që e shoqja punon, dhe ai kujdeset për fëmijën e tij në shtëpi, nuk tregon shenjë dhune por emancipim. Ndërsa aspekte të tjera të marrëdhënies së tij me ju dhe prindërit, janë detaje të cilat mund të trajtohen në një dimension më të gjerë. E vlerësoj faktin që ti nuk dorëzohesh në dëshirën tënde për ta ruajtur lidhjen me vëllanë dhe të jesh e pranishme në jetën e tij. Por nëse ai bën rezistencë dhe dëshiron që të vendosë kufij në këtë marrëdhënie, duhet të bësh durim, dhe të përpiqesh të fitosh besimin e tij. Nëse ti e fiton këtë besim, mund të ndezësh një dritë jeshile që ai të hapet me ty, dhe të mësosh të vërtetën e lidhjes së tij me të shoqen.

Nëse je një grua e dhunuar dhe ngurron të kërkoesh ndihmë sepse ndihesh në faj apo të vjen zor nga vetja mund të na e rrefësh historinë tënde këtu. Nëse ndihesh e frikësuar apo e kërcënuar nuk ka nevojë të tregosh emra dhe detaje, thjesht pyet dhe do të marrësh përgjigje.

Letrat tuaja mund t'i dërgoni direkt në adresën e psikologes Mirela Sula: sulamirela@gmail.com

SHËNIM: Duke qenë e pamundur të botojmë çdo letër që vjen në adresë të kësaj rubrike do të përpigemi të zgjedhim letrën që jep mundësinë e përgjigjes edhe për raste të tjera të ngjashme. Përgjigjet tuaja mund t'i gjeni vetëm te Shqiptarja.com, dhe jo përmes e-mailit.



Koment

Grabitja e vonuar



NGA ANILA BASHA

vijon nga faqja 1

...Ma merr mendja se doktori para se të shkojë në pushimet e nxehta familjare, me një varg problemesh personale e politike, ka gjetur zgjidhjen që gjithmonë e gjen, për të hapur një front të gjerë debatesh e diskutimesh mediataike: SHQUP. Edhe vetë ambasadori amerikan u bë pjesë e zhvillimeve dhe debateve për godinën e re të PD me takimin e zhvilluar në selinë e re ditën e djeshme.

Kemi gjithë këto ditë që merremi me fenomenin e grabitjes së SHQUP nën dritën e diellit me vendim qeverie, por nuk është ky problemi më i madhor. Alarmi se arka e shtetit është boshatisur, se sfida e qeverisë së re të Edi Ramës do të jetë gjetja e lekëve për pagesa rrogash e pensionesh, duhet të jetë kryefjala. Madje, pse jo, edhe investitimi. Çfarë fsheh kjo qeveri në ilçe me deklaratat e saj "gjoja" publike, në emër të transparencës, por që vetëm transparencë nuk është???

Se bie fjala, kemi kaq ditë që interesohe mi për të gjetur se kush janë subjektet që janë gjobitur nga Drejtoria e Kalibrimit, sipas deklaratave në konferencë për shtyp të vetë drejtores së institucionit. Askush nuk flet. Askush nuk jep përgjigje, për të informuar qytetarët se në "x" biznes bëhen abuzime me peshoret e kalibrimit. Jepet vetëm numri i subjekteve, masa e gjobës, por emrat nuk deklarohen. Mos vallë zyrtarët që po lënë detyrat (u kanë mbetur vetëm 10 ditë kohë) duan që këto gjopa t'i fshijnë nëpërmjet të tjerave gjopa që ua ngarkojnë bizneseve për të thënë se "drejtori ma hoqi gjobën"?

E njëjta gjë ndodhi me Autoritetin e Konkurrencës. Merren masa ndaj subjekteve, por nuk ka një listë të plotë të subjekteve të penalizuara. Që do të thotë, kushdo nga burokratët e vegjël të administratës, do të shfrytëzojë 10 ditët e fundit deri në marrjen e qeverisë nga maxhoranca e re, për të "gjetur një zgjidhje të hajrit".

A thua se ndryshon situata te taktimet...E njëjta gjë. Taksidarët kanë dalë në terren, duke prerë fleta

gjobash pa adresë, duke u sjellë si arrogantë pa kërkuar dokumentacion, e duke i futur bizneset në procedura apelimesh e gjyqesh, procedura, që do të vazhdojnë edhe në shtator.


Këto dhe shumë të tjera, janë grabitjet e fundit që po ndodhin. Por që ne nuk kemi asnjë mundësi t'i investigojmë. Çdo derë institucioni të përplaslet në fytyrë kur kërkon më shumë se deklarata zyrtare, e burokratët, ata që kërkojnë të gjejnë miqtë e të nesërme, përpiqen të ngrohin xhepat me shpresën se me këto para do të blejnë nesër pozicionin që gëzojnë aktualisht.

SHQUP-i, ishte vetëm preteksti i madh i një oqeani të gjerë abuzimesh të vogla që raportohen ditë pas dite, në çdo sektor dhe në çdo shtërim të jetës në vend. SHQUP

është "Shqiponja" e fundit që do të marrë në dorëzim Partia Demokratike. Dhe që, sipas gjithë gjasave, nuk do ta gëzojë dot pas deklaratave që ka bërë ministria e re dhe sharmante e Mbrotjtjes.

Nëse Berisha do ta kishte seriozisht grabitjen e SHQUP, do ta kishte kryer me kohë këtë veprim. Duhet të kishte menduar prej kohësh të

Askush nuk flet. Askush nuk jep përgjigje, për të informuar qytetarët se në "x" biznes bëhen abuzime me peshoret e kalibrimit. Jepet vetëm numri i subjekteve, masa e gjobës, por emrat nuk deklarohen



Ish-Shtëpia Qendore e Ushtrisë, tani selia e PD-së

instalohej aty, në mënyrë që askush mos ta nxirrte dot jashtë. Psh, para pesë vitesh. Sikur disa fushata zgjedhore të PD, të ishin bërë nga selia e SHQUP, nuk do të mundej dot asnjë institucion të nxirrte një urdhrë ndryshe për të anuluar të parin. Tani, është shumë vonë. Është një grabitje e vonuar. Një grabitje sa për sy e faqe për të tërhequr vëmendjen nga grabitjet e vogla poshtë e përjetë që shqetësojnë qytetarët.

Nuk duhet të shqetësohe mi për të. Por më shumë për transparencën e munguar. Hapja e letrave dhe nxjerrja në shesh e abuzimeve të mëdha të zyrtarëve të vegjël, ata të cilët rëndojnë te qytetarët e zakonshëm, do të duhet të jetë prioritet i qeverisë së re. Gjithçka po kryhet para syve tanë. Thjesht duhet të tregohemi të vëmendshëm, për të parë se si do të reagojë administrata e re që pritet të marrë detyrat në 9 shtator.

Koment

Shshshshttt... Flet Fullani!



NGA ILIR METAJ

vijon nga faqja 1

...i Bankës së Shqipërisë, Fullani: "Modeli i qeverisjes Berisha dështoi!"

Eh, sa mirë sikur Fullani, të ishte i aftë si bankier, sa gjysma e aftësisë që ka për të lëpirë...karrigen e pushtetit!

Daljet publike të Fullanit është vështirë t'i dallosh nga njëra-tjetra (nëse nuk është për shaminë që ndërrojnë xhepin e xhakëtës)- thote monotonisht të njëjtat gjëra: -importe që bien, eksporte që rriten

-rritje ekonomie nën potenciale për shkak të kërkesës së plogësht

-investime të ulëta dhe

konsum i ulët për shkak të pasigurisë

Por, këto të vërteta të thëna me gjysëm zëri dhe në mënyrën më monotone të mundshme për të zbehur forcën përgjeshtruese, që në fakt duhet të kishin ndaj versionit "shkëlqim ekonomik i vendit të 4-t në botë" të Berishës, mbuloheshin me një vel të bardhë: rritje pozitive e ekonomisë, ndonëse nën kapacitet për shkak të "krizés së eurozonës". Pra, për shkak të "armiku të jashtëm" vetëm. Ah ky "armiku i jashtëm" që s'na u nda gjithë jetën!

Pas çdo vendimi për ulje të normës bazë, Fullani thotë "e bëjmë për të rritur investimet". Por, gjashtë muaj më vonë, po njësoj reciton pikat me sipër. Pra? S'ka rritje investimesh, s'ka progres... Ah po, ka monoton si të duash!

Gubernurator, apo thjesht vëzhgues?

Çfarë mbahet mend: një ulje e njëpasnjëshme e normës bazë të interesit, duke arritur nivelet më të ulëta. Arsyeya e publikuar (recituar)? Nxitja dhe stimulimi i

"Një normë inflacioni nën kontroll"! E kur ka qenë ndryshe? Nuk mbahet mend ndryshe. A thua vërtet politike e suksesshme e Fullanit, apo thjesht varësi e çmimeve nga importet dhe ndaj monedhave të huaja?

kredive dhe si rrjedhojë stimulimi i rritjes ekonomike. Po kjo është një kampanjë që bie dhe nuk e dëgjon njeri. Sepse pas çdo ulje të tillë, kurrë nuk u provua efekti mbi nivelin e kredisë apo stimulimin e kërkesës. Përkundrazi, vazhdoi historia natyrale negative e të dy këtyre hallkave. Nëse ky mekanizëm u provua disa herë që nuk funksionoi, sepse ndjeshmëria e të dy këtyre hallkave është pothuaj zero ndaj kësaj norme, lind pyetja: pse lodhet Fullani duke

e përdorur këtë instrument të "gjoja politikës monetare". Përgjigja sipas meje është e thjeshtë: t'ja bëjë më të lirë borxhin qeverisë. Veçse, po jep shenja të qarta dashurie të njëjtë edhe për qeverinë që po vjen. Kësaj i thonë: paanësi, ose dashuri simetrike, ose dashuri e barazafuar, ose... Pikërisht ajo!

"Një normë inflacioni nën kontroll"! E kur ka qenë ndryshe? Nuk mbahet mend ndryshe. A thua vërtet politike e suksesshme e Fullanit, apo thjesht varësi e çmimeve nga importet dhe ndaj monedhave të huaja?

Populli pyet: Na u thuaj shkoqur o guvernator: po ecën ekonomia apo ka ngecur? Po e mban mirë timonin qeveria apo nuk ka timon fare? Po guvernatori nuk të ndihmon, ai thotë gjeje pengigjen vet. Thua punon si vëzhgues zgjedhjes i OSBE-së...

Full-hoby i Fullanit Çfarë mbahet mend tjetër? Dashuria e tij e madhe për... voleybollin. Epo njeri është, do ketë edhe hobby... Fullani (Banka e Shqipërisë) spon-



Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Ardian Fullani

sorizon ekipin kombëtar të voleybollit? Ah, epo ja një gjë e mirë! Jo?!

200 000 \$ për ekipin amator të punonjëseve të bankës?! Një skuadër voleybolli e supersponsorizuar, që luan kushedi ku dhe kushedi kur. Edhe kombëtarja e voleybollit femra do t'i kishte zili! Madje jo vetëm e Shqipërisë! Epo aristokrati Fullani e meriton të ketë një han privat, ku brenda ahahet, pihet, luhet e

dëfrehet...ndërsa jashtë të mbytet varferia!

Tek e fundit, është një guvernator që na e ka zili gjithë bota! Një guvernator kaq të pazëvendësueshem (jo vetëm për femrat e voleybollit të bankës) kaq brilant në rrethet shkencore (s'mund të jetë ndryshe), kaq bindës në argumente (opss) sa që e lutem për dy mandate si askënd tjetër më parë.


Mos o Zot mos të kishte pranuar të ri-rikonfirmohej!

PARADE FJALEKRYQESH N GA

Kadri Vokopola



FJALEKRYQI SPORTIV



HORIZONTAL

1. Frazier ish-kampion i botës.
4. Marchisio te Juventus.
10. Fare pa fe.
11. Eshhtë për të rishikuar me ngadalë aksionet.
13. Gjysmë rrethi.
15. Zinedine ish-as i futbollit.
17. Mbyllin portat.
18. Mbështesin skuadrën azzurra.
23. Inicialet e Giovinco-s.
24. ... GP me Jorge Lorenzo dhe Valentino Rossi.
27. Personazhi në foto.
29. Pak imagjinatë.
30. Personazhi në foto.
31. Gjysmë arrest.
32. Luiz, mesfushor.
33. Satelit i Jupitrit.
34. Një... gjerman.

35. Junior për shkurt.
36. Behrami te Napoli.
38. Stolis pa teke.
39. Dy anët e një elementi.
40. Juliete aktore.
41. Braziliansi i famshëm për një "gjethe të thatë".
42. Një ndenjëse me rezervë.


VERTIKAL

1. Me Utah në NBA.
2. Pak origjinale.
3. Gaucho i futbollit.
4. Të parat në cilësi.
5. Fillojnë lojën.
6. Oerter ish-kampion i hedhjes së diskut.
7. Diftong në duar.
8. Çirret pa gifte.
9. Të parat në orkestër.

11. Alessandro tani te Milan.
12. Miguel, mesfushor portugez.
14. Çani bomber.
16. Djalli... për Milan.
17. Matet pa kufij.
19. Nisin pa ekstreme.
20. Vrapojnë në pistë.
21. Dede trainer.
22. Lee, ish-kampion i

- 400 metrave në atletikë.
24. Basha te Torino.
25. Bedriu, ish-mesfushor bardheblu.
26. Një enë.
27. Edinson bomber.
28. Zakonist janë në krye.
30. Trezëqet bomber.
37. Qender për goca.
40. Parashesë për dy.

PËRGJIGJA E FJALEKRYQIT SPORTIV



FJALEKRYQI PA SKEME

DUHET TË NXINI 35 KUTI

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17
1																
2																
3																
4																
5																
6																
7																
8																
9																
10																
11																
12																

HORIZONTAL

1. U shkrua nga Kadare.
- Susanna që shkroi Anima Mundi.
2. Mendon për të tjerët më shumë se për veten.
- Gjysmë beteje.
- Mirë në qendër.
3. Një pjesë e riedukimit.
- Riparonte traktorë dikur (sigla).
- Një version i Ford.
- Casta... e kënduar nga Norma.
4. Ishin ushtarët e Decebailit.
- Maria tenisiste.
5. Skuadër greke.
- Vret Gildën.
6. Në mes të dhomës.
- Fliten në provinca.
7. Një pjesë e lajkëve.
- Shtrojnë me dado të lila.
- Një cigan.
8. Emri i Bismarck.
- Janë tek në larmi.
- Një diamant artificial.
9. Një të tillë page e preferojnë të gjithë.
- Eshhtë OTAN në Francë.
- Gjashtë italiane.

10. Cocker këngëtar.
24. Kufizojnë lëvizjet.
- Luciano trainer italian.
9. Fund tuneli.
- Eshhtë druri si pisha.
- Shtrohet edhe për dasma.
12. Lumi i Veronës.
- Një superpasanik.

VERTIKAL

1. Eshhtë reparati më për zemër.
2. Qe profeti që fluturoi në qiell.
3. Eshhtë shkop i fundit.
- Maria shkop për karambol.
- Shkruhet në mars.
4. Kufizojnë një heklar.
- Një poemë e Hesiodit.
- Të fundit në dhejtor.
- Në mes të rrugës.
5. Dëhet turist me një rit.
- Nagy që udhëhoqi kryengritjen antikomuniste në Hungari.
6. Hendrix që qe kitarist i famshëm.
- Hoffman aktor.
7. Festat pa fat.
- Sillen përgjysmë.

PËRGJIGJA E FJALEKRYQIT PA SKEME



I KRIPTOGRAFUAR

SHKRONJA E NJËJTË PËR NUMËR TË NJËJTË

C	A	R	L	12	3	15	3	12	8	3	
1	3	12	18	3	5	4	3	8	5		
16	8	15	4	5	3	5	5	2	16	3	
5	17	8	7	4	12	4	1	6	5		
4	10	8	5	7	8	12	12	2	7	7	3
7	7	5	7	3	18	10	8	3	7		
8	15	3	18	3	5	3	7	7	6		
5	16	9	12	4	7	4	6	8	18		
10	8	9	4	3	3	12	3	2	5		
18	2	5	8	13	8	7	8	7	15	4	
4	15	8	8	8	5	5	8	17	3	7	
6	3	1	4	7	3	1	5	4	7	3	

PËRGJIGJE E NUMRIT TË KALUAR

P	O	L	E	M	I	K	A	P	L	O	T
E	P	R	O	R	A	S	F	D	E		
E	T	E	S	T	E	T	S	I	F		
R	R	I	T	O	L	E	R	A	N	T	
R	A	T	I	E	L	E	P	A	T	I	A
E	O	R	I	G	A	M	I				
T	G	A	M	E	K	A	T	A	R	E	T
H	A	G	A	O	E	N	I	P	A		
A	R	E	N	A	T	I	K	O	R		
N	D	R	E	A	L	I	S	T	E	G	
A	H	E	T	R	E	A	H	L	A		
T	I	N	A	D	E	F	R	I	M	E	T

HOROSKOPI



DASHI
Do e vlerësoni mjaft ndihmën që do ju japë partneri juaj sot dhe do kaloni një ditë interesante pranë tij. Bashkëpunimi dhe mirëkuptimi nuk do ndalet në asnjë moment. Financat do jenë të paqëndrueshme, por me pak durim dhe maturi mund t'ia dilni mbanë ta stabilizoni situatën.



LUANI
Priten përmirësime të shumta gjatë kësaj dite në jetën tuaj sentimentale. Te dy me partnerin do tregoheni me të hapur dhe do provoni eksperiencë të reja se bashku. Beqaret do jenë shumë të sigjerte me disa persona që do i joshin në mënyrë që edhe ata të mos lëndohen.



SHIGJETARI
Kima në jetën tuaj në çift do jetë mjaft e ngrohë dhe komunikimi nuk do reshë për asnjë moment. Përfiloni për të folur edhe mbi të ardhmen për t'i kuptuar me mirë synimet e partnerit. Beqaret do i shprehin pa drujtë për qëllimet dhe shumë shpejt mund të fillojnë historit dashurore pasionante.



DEMI
Do jeni shumë kërkues në dashuri sot dhe do kënaqeni me pak. Partneri do mundohet shumë që ju të ndihni sa me mire, por ndonjëherë jo çdo gjë është aq e lehtë sa duket. Për beqaret nuk priten ndryshime të mëdha. Do jetë një ditë e qete dhe pa gjera të jashtëzakonshme.



VRGJËRËSHA
Ata që janë në një lidhje do e kenë të vështirë të flasin për çdo gjë me partnerin e tyre sot sepse ai do jetë me humor të keq. Prisi orët e pasdites sa të qetësohet. Beqaret duhet të bëjnë akoma edhe me shumë durim nëse duan të takojnë personin që do i përshtatet me se miri.



BRICJAPI
Nëse keni një lidhje prej shumë kohësh duhet të bëni shumë kujdes me impulsivitetin e tepruar. Në rast tensioni të madh, largohuni nga një-letëri në mënyrë që të mos thoni fjalë të fundit. Beqaret do jenë sharmante dhe do marrin shumë propozime. Do e dini se shpenzori dhe se në mbani në xhep.



BINJAKET
Surprizat në çift do jenë të njëpasnjëshme gjatë kësaj dite. Partneri do kujdeset mjaft për ju dhe nuk do iu lere të lodheni për asgjë. Sot ju do jeni si një princeshë e përkëdhelur. Beqaret do kenë mjaft takime interesante, por do e kenë të vështirë të fillojnë menjëherë një lidhje.



PESHORJA
Pasioni do jetë shumë i fortë gjatë kësaj dite. Partneri do kujdeset mjaft për ju dhe nuk do iu lere të lodheni për asgjë. Sot ju do jeni si një princeshë e përkëdhelur. Beqaret do kenë mjaft takime interesante, por do e kenë të vështirë të fillojnë menjëherë një lidhje.



UJORI
Çiftet do kalojnë një ditë mjaft delikate sot. Mos-marrëveshjet në çift do jenë të shumta dhe nga kokëfortësia e të dyve ato do duken të pafundme. Beqaret do gjenden përballë një zgjedhjeje të vështirë. Do jeni dy personat që do i joshin pa fund dhe të dy kanë cilësi për t'u adhuruar.



GAFORRJA
Dita do fillojë me tension dhe debat të shumta për jetën në çift, por me kalimin e orëve do i mendoni gjërat me kujdes dhe do jeni zgjidhje për çdo problem. Beqaret do përballen me surpriza mjaft të këndshme të cilat janë menduar me kujdes nga miqtë e ngushtë.



AKREPI
Ka shumë gjasa që për shkak të mungesës së përkujdesjes nga partneri ju ta kërkoni diku tjetër ngrohtësinë. Mendohuni mirë sepse me vonë mund të plasë një skandal i madh për ju. Beqaret do ndihen të kënaqur me jetën që po bëjnë dhe nuk do kenë aspak nevojë ta ndryshojnë atë.



PESHQIT
Ata që janë lashme në një lidhje do bëjnë çmos që ta përfundojnë edhe me tepër bashkëpunimin. Planetët do i kenë në krah kështu që duhet ta shfrytëzojnë këtë mundësi. Beqaret do jenë shumë kërenare për veten dhe nuk do pranëjnë çdo lloj ngacimi. Situata do përmirësohet pak nga pak.

SUDOKU

		8		1		6		
7	5		6		8		1	9
6				2				7
	2	7	4		1	8	3	
8	6						7	4
	3	1	5		7	2	9	
1			7					3
5	7		1		2		6	8
		9		5		7		

PËRGJIGJE E NUMRIT TË KALUAR

2	7	3	5	1	8	4	9	6
1	4	6	3	7	9	5	8	2
9	8	5	4	2	6	1	7	3
4	3	9	8	6	7	2	1	5
7	2	8	1	3	5	6	4	9
6	5	1	2	9	4	8	3	7
8	9	2	6	4	3	7	5	1
5	6	7	9	8	1	3	2	4
3	1	4	7	5	2	9	6	8

LAJME
NGA BOTA

Xhon Kerri: Assadi vrasës, s'do bëjmë sehir
Sekretari Amerikan i Shtetit Xhon Kerri ka deklaruar dje në një konferencë për shtyp se SHBA nuk mund të rrijë pa bërë asgjë lidhur me vrasjet me armë kimike në Siri. "Pas një konflikti prej 10 vjetësh, SHBA është e lodhur nga lufta, kërkon paqe, por ne do të gjykohejmë pa masë nga e gjithë bota nëse nuk do ta gjykojmë dhe do të tregohemi të verbër ndaj kësaj çështjeje", tha ai. Sipas Kerri, "Assad ka përdorur armët kimike kundër popullit të tij. Assad ka vrarë 1.429 vetë, ndërmjet të cilëve 426 fëmijë"- tha Kerri, duke shtuar se "unë vetë kam folur me ministrin e Jashtëm të Sirisë dhe i kam thënë të lejojë inspektorët të hyjnë të mblehdhin provat. Por ata i kanë fshehur provat, se ne e dimë ç'u bë me pas". Ne nuk mund të rrimë pa bërë asgjë, tha sekretari.

Thaçi: Gati zgjidhjet për energjinë e telekomit
Kryeministri Hashim Thaçi deklaroi dje në mbledhjen e qeverisë se takimi i raundit të 15-të Kosovë-Serbi, i zhvilluar më 27 gusht në Bruksel, mes kryeministrave të dy vendeve, u fokusua në përmbylljen e dy çështjeve jashtëzakonisht të rëndësishme, atë të energjisë dhe telekomit. "Mund të konfirmoj se jemi shumë afër zgjidhjes së këtyre dy çështjeve dhe kjo marrëveshje pritet të arrihet në takimin e ardhshëm. Marrëveshja do të jetë plotësisht në përputhje me ligjet dhe Kushtetutën e Kosovës", tha kryeministri Thaçi. "Besoj se deri më 8 shtator do të përmbyllem edhe këto dy çështje jashtëzakonisht të rëndësishme", shtoi ai.

Ish-zbuluesi Snouden nxjerr sekrete të reja
Ish-kontraktori i NSA-së Eduard Snouden ka shpërndarë sekrete të reja. Ai ka bërë publik një dokument tepër sekret, në të cilin flitet për shpërndarjen e "buxhetit të zi", paratë që ndahen për agjencitë e spiunazhit. Siç shkruan "Uashington Post", buxheti prej 52.6 miliardë dollarësh është miratuar për vitin 2013 për operacione të ndryshme në të gjithë botën nga agjencitë e zbulimit të SHBA-së. Pjesën e luanit në këtë buxhet e merr CIA, për të cilën Shtetet e Bashkuara të Amerikës japin më shumë se 14 miliardë dollarë në vit. Dokumenti i bërë publik nga Snouden përmban hollësi.

Greqi, vijon hemorragjia e depozitave bankare
Kanë vazhduar edhe në korrik, për të dytin muaj me radhë, rrjedhjet e depozitave nga bankat greke. Sipas të dhënave që publikoi Banka e Greqisë, në korrik rezervat e depozitave që kanë në banka bizneset dhe familjet, u ulën më tej me 288 milionë euro në raport me qershorin. Ato janë reduktuar në 162.4 miliardë euro. Sipas FMN, vlerësimi i radhës i programit të Greqisë do të kryhet në gjysmën e dytë të muajit shtator, megjithëse nuk është e qartë nëse do të ketë përfunduar para apo pas zgjedhjeve federale në Gjermani që do të mbahen më 22 shtator.

Egjipiti përballët sërish me manifestime
Egjipiti është duke u përballur me një seri manifestimesh, ndërsa ushtria e vendosur kudo në rrugët e qyteteve kryesore ka paralajmëruar se do të përgjigjet me dhunë, nëse do të sulmohen institucionet apo pozicionet e saj. Prostuesit, militantët të Vëllazërisë Myslimane, protestuan për grushtin ushtarak që largoi nga pushteti presidentin e zgjedhur me votë, Mohammed Morsi në muajin korrik dhe për arrestimin e disa eksponentëve të lartë të kësaj force politike në ditët e fundit. Në një sulm ndaj një postoblokut mbetoi i vrarë një ushtar më parë gjatë ditës.



Portoni numrin në Abissnet dhe përfiton:

**4 muaj internet
+3000lekë për 6 muaj**

- 0 lek tarifë fikse mujore
- Komunukim falas brënda rrjetit
- Tarifa deri në 80% më lirë
- Identifikimi i thirrjeve të humbura

Për të gjitha parapagimet 3 mujore paketa kushton vetëm 5.500 lekë
Për të gjitha parapagimet 6 mujore paketa kushton vetëm 10.000 lekë
Për të gjitha parapagimet 12 mujore paketa kushton vetëm 19.000 lekë
Oferta është e vlefshme për paketën 6 Mbps

Vizitoni dyqanet tona ose faqen e internetit www.abissnet.al

• Alba Malltezi Drejtore e Përgjithshme e Free and Fair Media Group
• Anila Basha Drejtore e Shqiptarja.com
• Edmond Arizaj Kryeredaktor
• Genc Kondi Zv. Kryeredaktor
• Politika: Jakin Marena
Aktualitet: Granit Sokolaj
Ekonomia: Genc Kondi
Social: Esmeralda Keta
Kulturë: Admirina Peçi
Design: Altin Aliaj Genti Manelli
Website: Suela Gera
Departamenti i Marketingut: Cel: +355696060419 marketing@shqiptarja.com
Shpërndarja: Saimir Zenelaj cel: +355696060418 cel: +355696088847

Redaksia: Rruga: "Dervish Hima" tre kullat, kulla e dytë-Tiranë. E-mail: redaksia@shqiptarja.com - Website: www.shqiptarja.com - Mobile: +355696060421 - Shtypur në shtypshkronjën: A.K shpk, Rruga 5 Maji, Tiranë